

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5998
E hënë, 10 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Thaçi: Me ndërmjetësimin e ShBA-së dialogu do të përmbillet me njohje reciproke | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI | F. 4-5

QEVERIA TË JAPË SHPJEGIME TË HOLLËSISHME NË KUVEND PËR RECIPROCITETIN ME SERBINË



Ish-ministrja e Dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka ftuar qeverinë e re që t'i japë shpjegimet e duhura për aplikimin e reciprocitetit në raport me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se para se të fillojë të zbatohet ky parim

qeveria e re në hollësi duhet ta shpjegojë atë në Kuvend. Sipas saj, deklaratimet politike të kryeministrit Kurti për këtë çështje janë të pamjaftueshme. Tahiri ka vlerësuar se për fazën finale të dialogut me Serbinë, Kosovës i duhet një konsensus

nacional. "Kosova pati mjaft polarizime, tani është koha që gjërat të bëhen me një gjuhë të përbashkët", ka thënë ajo. Tahiri ka folur edhe për rolin e opozitës së re. Ajo ka thënë se shpreson që kjo opozitë të jetë konstruktive dhe jo sikurse opozita e kaluar

OPINION

ÇFARË DO TË NDODHË ME SHOQIPTARËT NË MAQEDONINË E VERIUT? | F. 11

Arsim SINANI



AKTUALE

QKUK-ja KONFIRMON SE NUK KA TË SËMURË ME KORONAVIRUS NË KOSOVË | F. 7

FUSHATA PËR ZGJEDHJET NË PODUJEVË FILLON MË 3 MARS | F. 5

EKONOMI



QEVERIA E KOSOVËS DUHET TA KETË PRIORITET ZHVILLIMIN EKONOMIK | F. 9

SHOQPËRIA SË SHPEJTI ME LIGJ PËR SEKTORIN FINTECH | F. 9

KULTURË

ENCIKLOPEDI PËR ÇAMËRINË | F. 12

Mehdi GURRA

VIZIONI PËR JETËN DHE ARDHMËRINË | F. 13

Shyqri GALICA



I jepet lamtumira e fundit bilbilit të Kosovës, Nexhmije Pagarusha

Në Pagarushë të Malishevës të dielën është varrosur këngëtarja e njohur Nexhmije Pagarusha, e cila ndërroi jetë të premtën në moshën 86-vjeçare. Në Teatrin Kombëtar të

Kosovës u bënë homazhe dhe më pas u mbajt një akademi përkujtimore për jetën dhe veprën e saj. Në këtë ceremoni morën pjesë politikanë dhe artistë nga vendi dhe

rajoni. Në akademinë përkujtimore u tha se muzika dhe arti kanë humbur ikonën e tyre, kurse kombi ka humbur anëtarin më të dashur e më të çmuar

RENOVA
PUTZ
Magëdoni
Xhepçishtë-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Mbërrin në Tiranë delegacioni i Komisionit të Venecias


TIRANË, 9 SHKURT - Një përfaqësi e Delegacionit të Venecias ka mbërritur në Tiranë për të mbledhur të dhëna dhe fakte rreth Metës dhe zbatimit ligjor për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Sot (e hënë), në orën 9:15, në

Kryesinë e Kuvendit, zëvendëskryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi, do të presë delegacionin e Komisionit të Venecias.

Më pas, nga ora 10:05-10:45, përfaqësuesit e Komisionit të Venecias do të kenë një takim me grupin parlamentar të PS-

së, dhe nga ora 10:50-11:30 me grupet e opozitës.

Në agjendën e Komisionit të Venecias në Kryesinë e Kuvendit, në orën 11:35 - 12:30 është parashikuar edhe takimi me Komisionin e Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik.



Fushata për zgjedhjet paraprake në Nju Hempshër

Zgjedhjet paraprake nesër (e martë) në Nju Hempshër mund të prodhojnë një rezultat të ndarë, gjë që mund të çonte në një zgjatje të garës mes kandidatëve demokratë në shtetet që pasojnë, Nevada, Karolina e Jugut dhe të tjera, në prag të asaj që quhet Super e marta në muajin mars

WASHINGTON, 9 SHKURT - Fokusi i zgjedhjeve paraprake presidenciale për vitin 2020 për demokratët tani është zhvendosur në shtetin Nju Hempshër pas konfuzionit për rezultatet e vonuara në shtetin Ajova, i cili u krijoi vështirësi kandidatëve kryesorë. Zgjedhjet paraprake të martën në Nju Hempshër do të jenë gara e dytë për pretendentët që kërkojnë ta marrin emërimin e partisë së tyre. Disa votues në Nju Hempshër thonë se janë të irrituar që Ajova nuk nxori një fitues të qartë, ka njoftuar voa. "Ideja është të zgjedhim dike që do të jetë fitues. Pra nëse dikush fiton në Ajova, e di që ka hyrë në garë për të fituar", thotë votuesi Daniel Torpin.

Por rezultatet në Nju Hempshër nuk përputhen gjithmonë me ato të Ajoas.

Shumë prej kandidatëve të Partisë Demokratike shkuan për herë të parë në Nju Hempshër për të bërë fushatë pa ditur rezultatet e votimit në Ajova. Rezultat u vonuan për shkak të problemeve teknike.

Pete Buttigieg, ish-kryetar i bashkisë së South Bendit, në shtetin Indiana, fillimisht tha

se po vinte në Nju Hempshër si fitimtar, por më vonë reagoi me kujdes ndaj epërsisë së tij në Ajova, kur ishin raportuar vetëm rezultatet e pjesshme. "Pak më vonë sesa parashikuam, por më mirë vonë se kurrë", tha Buttigieg. Senatori i Vermontit, Bernie Sanders, i cili ishte shumë pranë, në vendin e dytë, theksoi se fitoi më shumë vota në dy raundet e para në sistemin e komplikuar të zgjedhjeve në Ajova.

Rezultatet fillestare të pjesshme e vunë senatorin Elizabeth Warren, në vendin e tretë. Ndërsa ish-nënpresidenti Joe Biden doli në vendin e katërt, një goditje kjo për fushatën e tij.

Bideni nuk e pranoi disfatën duke thënë se është koha që të flasë Nju Hempshëri. Në vitin 2016 Hillary Clinton fitoi në Ajova por humbi keq nga Sanders në Nju Hempshër. Këtë vit në Nju Hempshër është e paqartë nëse fituesi do të përcaktojë nëse demokratët mbështesin krahun liberal apo të moderuar të partisë.

Kandidatët liberalë si Warren dhe Sanders dëshirojnë të rrisin pjesëmarrjen e votuesve



duke bërë thirrje për ndryshime transformuese - duke e bërë kujdesin shëndetësor dhe arsimin në kolegji falas.

Përkrahësit e Bernie Sanders në Mançester, Nju Hempshër thonë se demokratët thjesht duhet të dalin të votojnë për t'i fituar zgjedhjet presidenciale në nëntor.

Ka shumë mbështetje nga Partia Demokratike, por është aq e shpërndarë. Askush nuk po e

kupton se bashkimi është vërtet ajo që do të ndihmojë këtë parti për të fituar.

Megjithatë, presidenti Trump ka denoncuar propozimet e demokratëve për kujdes të zgjeruar shëndetësor si socializëm ndërsa fillon fushatën për rizgjedhje. Sidoqoftë, kandidatët e moderuar si Buttigieg, Biden dhe senatorja e Minesotës Amy Klobučar po propozojnë përmirësime shtesë në sistemin

aktual, si një mënyrë për të fituar përsëri votuesit e pavarur dhe republikanët e pakënaqur. Kështu që, në fund të fundit, zgjedhjet paraprake në Nju Hampshër mund të prodhojnë një rezultat të ndarë, gjë që mund të çonte në një zgjatje të garës mes kandidatëve demokratë në shtetet që pasojnë, Nevada, Karolina e Jugut dhe të tjera, në prag të asaj që quhet Super e Marta në muajin mars.


Basha: Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë zgjidhja

TIRANË, 9 SHKURT - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, duke iu përgjigjur komenteve të qytetarëve në rrjetet sociale, thotë se protesta ka pasur dhe do të ketë pa pushim, nga minatorët te naftëtarët, nga studentët te bizneset e vogla e të mesme. I pyetur për zgjedhje të parakohshme, Basha thotë se "e vetmja rrugë për zgjidhjen

e krizës së rëndë politike, social-ekonomike dhe institucionale në vend, janë zgjedhjet e parakohshme parlamentare dhe zgjedhjet kushtetuese lokale, nga ku qytetarët me votë të lirë duhet të zgjedhin qeverisjen e tyre". "Këtë qëndrim e kam ndarë gjatë kësaj kohe edhe me shumë partnerë ndërkombëtarë që jam takuar, të cilët

janë të ndërgjegjshëm tashmë se vendi ka nevojë për zgjidhje urgjente dhe se kriza që po kalon vendi duhet të marrë fund sa më parë. Nuk pres dhe nuk duhet të presim që zgjidhjen të na e ofrojnë partnerët tanë. Ata kanë qenë dhe janë aty gjithmonë, si miq të mirë të Shqipërisë, për të na ndihmuar. Por Shqipëria ka të gjitha mundësitë që të dalë

nga transicioni i tejzgjatur, nëpërmjet bashkimit të shumicës së shqiptarëve të ndershëm, që kanë vendosur ta ndërtojnë jetën në vendin e tyre, duke i dhënë zgjidhje njëherë e mirë problematikave që kanë prodhuar krizë të herë pas hershme", tha Basha. "Protestat nuk janë qëllim në vetvete, por janë një ndër të shumta instrumente



që ne po përdorim për të realizuar qëllimin tonë për të larguar qeverinë", përgjigjet Basha, duke shtuar se "zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë zgjidhja dhe shumë shpejt do t'i kemi ato".

Thaçi: Me ndërmjetësimin e ShBA-së dialogu do të përmbillet me njohje reciproke



“Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka treguar vëmendje të madhe për forcimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Letrat e tij e kanë skicuar epilogun e procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë i cili duhet të përfundojë me njohje reciproke. Nën udhëheqjen e presidentit Trump dhe punën e shkëlqyeshme të ambasadorit Grenell jam besimplotë se ky proces do të përmbillet së shpejti me njohje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë të dielën presidenti Hashim Thaçi

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 SHKURT - Procesi i dialogut midis Kosovës dhe Serbisë do të përmbillet së shpejti me njohje reciproke falë punës së shkëlqyeshme të Shteteve të Bashkuara nën udhëheqjen e presidentit Donald Trump. Kështu ka thënë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” të dielën.

Thaçi tha se epilogu i procesit të dialogut është skicuar, duke iu referuar letrave të presidentit Trump, kohë më parë, drejtuar presidentit të Kosovës dhe atij të Serbisë. “Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka treguar vëmendje të madhe për forcimin e paqes dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Letrat e tij e kanë skicuar epilogun e procesit të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili duhet të përfundojë me njohje reciproke. Nën udhëheqjen e presidentit Trump dhe punën e shkëlqyeshme të ambasadorit Grenell jam besimplotë se ky proces do të përmbillet së shpejti me njohje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Jemi të bekuar me përkrahjen e përhershme të ShBA-së për popullin dhe shtetin e Kosovës”, ka shkruar Thaçi.

Gjatë vizitës së tij në Kosovë, i dërguari i posaçëm i ShBA-së për

çështjen e dialogut Kosovë-Serbi, Richard Grenell, kishte theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidenti Donald Trump janë të interesuar që t’i zgjidhin problemet dhe çështjet e hapura në bisedimet Kosovë - Serbi.

Vizita e tij ndodhi në kohën kur u arrit marrëveshja e funksionalizimit të linjës ajrore midis Prishtinës dhe Beogradit, me ndërmjetësim të ambasadorit Grenell dhe ambasadorin Robert O’Brien, këshilltar i sigurisë kombëtare të Shtetësisë së Bardhë.

Presidenti amerikan Donald Trump e kishte quajtur fitore të madhe arritjen e marrëveshjes për fluturimet direkte në mes të dy vendeve.

Javën e kaluar i dërguari i presidentit amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori Richard Grenell, përmes një postimi në llogarinë e vet në “Twitter” i ka thënë kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, se taksa ndaj mallrave serbe duhet të hiqet dhe se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka të drejtë në këtë drejtim. “Kadri, Shtetet e Bashkuara po kërkojnë që Kosova ta heqë tarifën 100 për qind. Ajo e dëmton Kosovën dhe pengon bizneset për krijimin e vendeve të punës. Albini ka të drejtë për këtë”, ka shkruar Grenell.

Ndaj këtij postimi ka reaguar

kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, i cili Kurtin e ka quajtur gënjeshtar. “Zotëri ambasador, Albini është gënjeshtar. Propozimi im për taksën është shumë i qartë qysh prej janarit 2019. Albini nuk e ka mbështetur dhe ka bërë fushatë kundër tij. Unë jam i shqetësuar me nxitimin e qeverisë së re për t’u marrë me këtë çështje pa një plan konkret, i cili e vendos interesin më të mirë të Kosovës në rend të parë”, ka shkruar Veseli në “Twitter”.

Veseli para këtij statusi kishte thënë se taksa ndaj importeve serbe ka qenë vendim dinjitoz i shtetit tonë për t’iu kundërvënë sulmeve të njëpasnjëshme që Serbia ka bërë kundër Kosovës. “Shpreh shqetësimin për ngutën e tepruar të kryeministrit të ri për t’i përmbushur kërkesat e Serbisë dhe për ta rehatuar Listën Serbe, e cila u largua nga qeveria e kaluar për shkak të taksës”, ka thënë Veseli. Sipas tij, qeveria e re duhet të mos të dorëzohet para Serbisë dhe vendimeve të mëdha që e presin Kosovën. “Një qeveri ka rënë si pasojë e taksës, gjë që ka dobësuar për një kohë Kosovën. Prandaj, nuk duhet të ketë manovrimet politike për këtë temë të ndjeshme, e cila rrezikon ta dëmtojë më tej vendin tonë. Qeveria e re duhet të mos të dorëzohet para Serbisë, përpara sfidave dhe vendimeve të mëdha që e presin Kosovën”, ka deklaruar Veseli.

Partia e Veselit ka qenë pjesë e koalicionit qeveritar kur ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë vendim për taksën në nëntor të vitit 2018.

Thirrje për heqje të taksës patën bërë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, mirëpo Haradinaj nuk ishte zbrapsur. Të enjten edhe vetë Haradinaj i ka kërkuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që të mos heqë dorë nga kjo masë.

Më i ashpri në këtë drejtim ka qenë ish-kryeministri Ramush Haradinaj, i cili me fanatizëm e kishte mbrojtur taksën ndaj Serbisë gjatë qeverisjes së tij.

Përmes një letre publike drejtuar Kurtit, në të cilën ia ka përmendur sakrificat e kryeministrit të ri, Haradinaj e ka lutur Kurtin që të mos e heqë taksën. “Ne mund të mos

pajtohemi për shumë gjëra të politikës ditore, por sakrificën gjithmonë ta kam njohur. Për shkak të kësaj sakrifice dua që personalisht të lutem të mos e heqësh taksën ndaj Serbisë. Albin, mos e lejo tregun e fitimit të mbi 400 milionë eurove për Serbinë, shtetin i cili të ka rrahur e të ka torturuar. Shtetin që me paratë e popullit të Kosovës blen armë në Rusi. Të lutem, mos e kamufllo këtë vendim sovran me terme të mjegullta siç është reciprociteti”, ka shkruar Haradinaj.

Por kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar zëvendësimin e taksës 100 për qind të vendosur nga qeveria e kaluar për importet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina me reciprocitetin e plotë politik, ekonomik dhe tregtar.



Merkeli e fton Kurtin në Berlin

PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar telegramin e urimit të kancelares së Republikës Federale të Gjermanisë, Angela Merkel, për marrjen e detyrës së re në krye të ekzekutivit, të cilën ia ka dorëzuar ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt.

Në urimin e kancelares Merkel thuhet: “Para jush dhe qeverisë Tuaj ndodhen sfida të vështira dhe të rëndësishme, siç janë ndërtimi dhe forcimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit

dhe krimit të organizuar, përmirësimi i situatës ekonomike dhe, në veçanti, dialogu për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Këta janë hapat kryesorë për forcimin e perspektivës evropiane të shtetit Tuaj. Qeveria Federale vazhdon ta mbështesë Kosovën në këtë rrugëtim. Do të gëzohesha t’ju mirëpres së shpejti në Berlin”, thuhet në letrën e kancelares Merkel dërguar kryeministrit Kurti, duke i uruar fat dhe shumë suksese në sfidat që ka përpara.



FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

Qeveria të japë shpjegime të hollësishme në Kuvend për reciprocitetin me Serbinë

Ish-ministrja e Dialogut Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka ftuar qeverinë e re që t'i japë shpjegimet e duhura për aplikimin e reciprocitetit në raport me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se para se të fillojë të zbatohet ky parim qeveria e re në hollësi duhet ta shpjegojë atë në Kuvend. Sipas saj, deklaratimet politike të kryeministrit Kurti për këtë çështje janë të pamjaftueshme. Tahiri ka vlerësuar se për fazën finale të dialogut me Serbinë, Kosovës i duhet një konsensus nacional. "Kosova pati mjaft polarizime, tani është koha që gjërat të bëhen me një gjuhë të përbashkët", ka thënë ajo. Tahiri ka folur edhe për rolin e opozitës së re. Ajo ka thënë se shpreson që kjo opozitë të jetë konstruktive dhe jo sikurse opozita e kaluar

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ish-ministrja për Dialogun Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka bërë me dije se Qeveria e re duhet të japë shpjegime të hollësishme për reciprocitetin me Serbinë, para se të zëvendësohet me taksën 100 për qind. Ajo ka deklaruar se shpjegimet deri në detaje të zbatimit të këtij parimi duhet të bëhen në Kuvendin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se Kosovës i duhet unitet për këtë çështje. "Tani po dëgjoj tezën e reciprocitetit si zëvendësim për taksën. T'ju them të drejtën, nuk kam dëgjuar një shpjegim nga ky koalicion qeverisës se çfarë nënkupton

reciprociteti. Qeveria duhet të japë shpjegime të hollësishme në Kuvend para se ta marrë vendimin për ta zëvendësuar taksën kundër Serbisë me reciprocitet", ka thënë Tahiri. Sipas saj, nuk janë të mjaftueshme vetëm deklaratimet e kryeministrit se taksë prej 100 përqindësh do të zëvendësohet me reciprocitet të plotë. "Kosova pati mjaft polarizime, tani është koha që gjërat të bëhen me një gjuhë të përbashkët. Nuk mjaftojnë deklaratat e fundit (nga kryeministri), ato janë deklarata politike. Për mua që të jap përgjigje për këtë çështje me duhet të dëgjojë një elaborim të hollësishëm çfarë nënkupton dhe si zbatohet reciprociteti. Reciprociteti mes dy shteteve të pavarura përcaktohet me

konventa ndërkombëtare, këtu kemi situatën e mosnjohjes mes dy shteteve, po ashtu kemi marrëveshje të arritura në Bruksel", ka thënë ajo.

Tahiri ka vlerësuar se vazhdimi i dialogut Kosovë - Serbi për fazën finale është i domosdoshëm. "Së pari duhet të them se dialogu me një ndërmjetësim ndërkombëtar është i domosdoshëm, edhe pse ne nuk e kemi dashur një proces për arsye të luftës dhe gjenocidit që bëri Serbia, megjithatë pas luftërave vjen paqja dhe marrëdhëniet paqësore dhe mbyllet kapitulli i luftërave dhe armiqësive. Po shpresoj se në fazën që po hyjmë do të jetë faza finale e dialogut, sepse mjaft janë bërë procese me Serbinë", është shprehur ajo.

Tahiri ka folur edhe për rolin e

duhet të dëgjoj një elaborim të hollësishëm çfarë nënkupton dhe si zbatohet reciprociteti. Reciprociteti mes dy shteteve të pavarura përcaktohet me konventa ndërkombëtare, këtu kemi situatën e mosnjohjes mes dy shteteve, po ashtu kemi marrëveshje të arritura në Bruksel që në kuadër të këtyre kemi edhe kapitullin 35, që e kemi arritur në Bruksel, se rruget e Serbisë për në BE kalon nga Kosova, sepse ky kapitull kushtëzon Serbinë. 33 marrëveshjet janë mbi bazën e reciprocitetit të plotë, pra janë të bazuara në ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, këtë e kam thënë gjithmonë dhe po e them edhe tani. Dhe po ju them se një pjesë e rëndësishme e këtyre marrëveshjeve janë zbatuar.

“Epoka e re”: Si e shihni rolin e opozitës së re në raport me dialogun?

Tahiri: Uroj që opozita e re të mos bëjë siç bëri opozita e vjetër, sepse mjaft u dëmtua imazhi i Kosovës me pamje të dhunshme në Kuvend e në rrugë.

“Epoka e re”: Po tash, si duhet të vazhdohet me këtë proces?

Tahiri: Së pari duhet të them se dialogu me një ndërmjetësim ndërkombëtar është i domosdoshëm, edhe pse ne nuk e kemi dashur një proces për arsye të luftës dhe gjenocidit që bëri Serbia. Megjithatë, pas luftërave vjen paqja dhe marrëdhëniet paqësore dhe mbyllet kapitulli i luftërave dhe armiqësisë. Po shpresoj se në fazën që po hyjmë do të jetë faza finale e dialogut, sepse mjaft janë bërë procese me Serbinë. Ishte Rambujeja, Vjena, pastaj shtatë vjet dialogu që pata rastin unë ta udhëheq. Tani është koha që të mbyllet ky proces.

“Epoka e re”: Faza finale e dialogu duhet të bazohet në këto marrëveshje që janë arritur apo si?

Tahiri: Koncepti i dialogut të Brukselit ka qenë vendosja e marrëdhënies fqinjësore sipas parimeve euroatlantike, fushë për fushë. Nëse tani shkojmë në bisedimet e fazës finale, atëherë kjo fazë duhet të definojë që Kosova dhe Serbia të njihen reciprokisht në kufijtë aktualë.

“Epoka e re”: Mirëpo Serbia po lë të nënkuptojë se nuk mund ta njohë Kosovën pa përfitur diçka, ndërsa partnerët ndërkombëtarë kanë bërë me dije se për arritjen e marrëveshjes finale duhet një kompromis mes dy palëve?

Tahiri: Ky diskursi se agresori dhe viktimat mund të bëjnë marrëveshje me një drejtësi të barabartë është qasja më e gabueshme e cila nuk sjell paqe, por sjell situata të rënda. Agresori duhet ta marrë përgjegjësinë dhe të ndëshkohet, kjo ka ndodhur deri më tani gjatë historisë. Pra, Serbisë duhet t'i bëhet me dije në bisedime se ajo është pala që ka bërë agresion në

Kosovë dhe ne jemi viktimat. Fatkeqësisht, për shkakë gjeostrategjike, bashkësia ndërkombëtare është sjell më butë ndaj Serbisë, duke u munduar që me përkëdhelje t'ia shkëpusin asaj lidhjet me Rusinë. Mirëpo kur të vijë afër anëtarësimit në BE, Serbia duhet ta zgjedhë ose Brukselin ose Moskën.

“Epoka e re”: Së fundi, me ndërmjetësimin e përfaqësuesit special të ShBA-së për dialogun Beograd - Prishtinë, Richard Grenell, kemi pasur një marrëveshje për hapjen e një linje ajrore Prishtinë - Beograd dhe një përpjekje rreth vendosjes së linjës hekurudhore midis dy vendeve. Cili është mendimi juaj për këto çështje?

Tahiri: Nga këndi im i kam parë si masa të rikthimit të mirëbesimit për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Meqenëse nuk i kam parë dokumentet, përveç asaj që është dhënë në medie, po rezervohem të flas se sa është mbrojtur sovraniteti dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

“Epoka e re”: Kryeministri Kurti është shprehur i gatshëm ta udhëheqë dialogun. Si e shihni z. Kurti në këtë proces?

Tahiri: Atë e shoh në një situatë shumë paradoksale. Si një ish-lider i opozitës që ka qenë i përbetuar kundër bisedimeve me Serbinë, në ekspozitë e tij në Kuvend disi me eufori fluturoi duke thënë se do t'i udhëheqë bisedimet. Tani është koha e tij dhe e koalicionit që ai udhëheq që të përgatiten mirë për këtë proces. Të përgatisin një delegacion gjithëpërfshirës. Është me rëndësi që brenda këtij koalicioni të jenë edhe opozita dhe shoqëria civile. Kosovës i duhet një bazë e gjerë e legjitimitetit për të marrë vendime të rëndësishme për vendin në raport me Serbinë. Gjithashtu, ky koalicion e ka për obligim ta përgatisë mirë një platformë shtetërore për këtë fazë, në të cilën duhet të vendosen vijat e kuqe. Kjo qeveri e ka për obligim që të jetë e qartë se nuk do të ketë bisedime për territore, për kufij, për rregullin e brendshëm të Kosovës. Pra, ata duhet të jenë në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës.

“Epoka e re”: A mendoni se është larguar përfundimisht nga tavolina ideja e çështjes së kufijve?

Tahiri: Së pari, mendoj se Kosova, Shqipëria dhe kombi shqiptar e kanë dhënë provimin për këtë çështje. E kundërshtuan fuqishëm këtë çështje, madje edhe Thaçi e Rama që e përkrahën këtë ide e panë këtë punë. Ky është një mesazh edhe për këta që kanë ardhur në pushtet tani. Së dyti, meqenëse gjeopolitika është shumë dinamike, sidomos nga vende joperëndimore si Rusia, Kina dhe Turqia, unë them se ne duhet të jemi syçelë dhe të përgatitur për t'ua prerë rrugën këtyre ideve.

KQZ-ja fillon përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve në Podujevë

Fushata për zgjedhjet në Podujevë fillon më 3 mars

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka filluar përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Komunën e Podujevës pas dorëheqjes së Agim Veliut, i cili në qeverinë e re është emëruar ministër i Punëve të Brendshme. Sipas KQZ-së, fushata zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët fillon më 3 mars dhe përfundon më 13 mars. KQZ-ja ka miratuar planin e buxhetit për organizimin e këtyre zgjedhjeve. Buxheti i aprovuar nga KQZ-ja është në vlerë 491 mijë e 517 euro

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 SHKURT - Pas shpalljes së datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës, më 15 mars, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë disa vendime lidhur me procesin e përgatitjeve për organizimin e këtyre zgjedhjeve. Në fillim të mbledhjes Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori vendim që t'i shkurtojë afatet kohore për organizimin e këtyre zgjedhjeve në përpunje me rrethanat. Pas këtij vendimi, KQZ-ja ka miratuar planin operacional për organizimin e zgjedhjeve në këtë komunë sipas vendimit të KQZ-së për caktimin e afateve të aktiviteteve.

Aplikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve fillon më 8 shkurt dhe më 17 shkurt 2020. Tërheqja e shortit për renditjen e subjekteve politike dhe kandidatëve në fletëvotim do të mbahet më 2 mars, ndërsaq periudha e aplikimit për t'u regjistruar votues jashtë Kosovës fillon më 16 shkurt dhe përfundon më 23 shkurt 2020. Sipas KQZ-së, peri-

udha e votimit përmes postës fillon më 3 mars dhe përfundon më 13 mars 2020. “Periudha e aplikimit për t'u regjistruar votues me nevoja të veçanta fillon më 26 shkurt dhe përfundon më 1 mars 2020. Fushata zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët fillon më 3 mars dhe përfundon më 13 mars 2020. Afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve të subjekteve politike dhe OJQ-ve fillon më 14 shkurt dhe përfundon më 10 mars 2020. Afati për aplikim për akreditim të vëzhguesve ndërkombëtarë të zgjedhjeve dhe medieve fillon më 14 shkurt dhe përfundon më 12 mars 2020. Periudha për formimin e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve fillon më 8 shkurt dhe përfundon më 14 shkurt 2020. Periudha për formimin e Këshillave të Vendvotimit fillon më 25 shkurt dhe përfundon më 6 mars 2020”, është theksuar në njoftimin e KQZ-së.

Në këtë mbledhje KQZ-ja ka miratuar planin e buxhetit për organizimin e këtyre zgjedhjeve. Buxheti i aprovuar nga KQZ-ja është në vlerë 491 mijë e 517 euro.



opozitës së re. Ajo ka thënë se shpreson që kjo opozitë të jetë konstruktive dhe jo sikurse opozita e kaluar. “Uroj që opozita e re të mos bëjë siç bëri opozita e vjetër, sepse mjaft u dëmtua imazhi i Kosovës me pamje të dhunshme në Kuvend e në rrugë”, është shprehur Tahiri.

“Epoka e re”: Znj. Tahiri, e keni dëgjuar idenë e fundit të kryeministrit rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, zëvendësimin e taksës me reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar?

Tahiri: Taksa 100 për qind ndaj Serbisë ka mbyllur rrugën e disa lojërave të rrezikshme për ndërrim kufijsh. Tani po dëgjoj tezën e reciprocitetit si zëvendësim për taksën. T'ju them të drejtën nuk kam dëgjuar një shpjegim nga ky koalicion qeverisës se çfarë nënkupton reciprociteti. Qeveria duhet të japë shpjegime të hollësishme në Kuvend para se ta marrë vendimin për ta zëvendësuar taksën kundër Serbisë me reciprocitet. Kosova pati mjaft polarizime, tani është koha që gjërat të bëhen me një gjuhë të përbashkët. Nuk mjaftojnë deklaratat e fundit (nga kryeministri). Ato janë deklarata politike. Për mua që të jap përgjigje për këtë çështje më

Vendet skeptike të BE-së, pengesë për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 9 SHKURT - Metodologjia e re për anëtarësim në Bashkimin Evropian nga shoqëria civile shihet si frenim i zgjerimit dhe anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, por jo edhe pengesë për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Kjo metodologji që u miratua më 5 shkurt (2020) ka për qëllim rivendosijen e perspektivës së besueshme evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pjesëtarë të shoqërisë civile në Kosovë vlerësojnë se e njëjta nuk mund të ndikojë në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët kosovarë sa mund të ndikojë skepticizmi te disa shtete anëtare të BE-së, si Franca e Holanda, të cilat nuk janë pajtuar deri më tani për futjen në agjendë të çështjes së liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Arbresha Loxha, drejtoreshë e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova tashmë i ka përmbushur kushtet e kërkuara për liberalizim dhe se metodologjia e re e Komisionit Evropian nuk mund të ndikojë në këtë proces. Ajo çfarë u ka mbetur institucioneve të Kosovës, sipas saj, është luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. "Kosova sipas Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, në të kaluarën është konsideruar se i



ka përmbushur të gjitha kriteret, përkundër faktit që nevojitet të bëhet ende punë në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, sidomos atij të profilit të lartë. Por, mbetet që të binden vendet skeptike, të cilat kanë penguar deri më tash liberalizimin e vizave, në mënyrë që liberalizimi i vizave të ndodhë", ka theksuar Loxha. Visar Xhambazi nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) thotë se liberalizimi i vizave është proces i ndarë dhe se është drejt

finalizimit. "Ky proces pak a shumë është i mbyllur, pritet vetëm konfirmimi i vendeve anëtare dhe të procedohet tutje sepse, sipas Komisionit Evropian, Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe kjo normalisht nuk do të ketë kurrfarë ndikimi", thotë Xhambazi.

Xhambazi ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se nëse qeveria e re e shfuqizon tarifën 100 për qind të vendosur për mallrat me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina, liberalizimi do të

mund të ndodhte më shpejt. Sipas tij, ky do të ishte një hap pozitiv dhe do të ndikonte në politikbërjen e BE-së. "Normalisht që do të pritet me pozitivitet në qoftë se tërhiqet taksa sepse nuk ka më asnjë argument se pse duhet të stajojë liberalizimi i vizave apo edhe negociatat ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka deklaruar Xhambazi.

Sa i përket dinamikës dhe kohës, drejtoresha e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Arbresha Loxha, nuk pret që liberalizimi të

ndodhë në gjysmën e parë të këtij viti. "Unë nuk pres që kjo të ndodhë në presidencën e Kroacisë, por mund të jemi ndoshta më pozitivë që kjo do të ndodhte në presidencën e gjermanëve, të cilët e marrin atë pas qershorit kur të përfundojë presidenca ose lidhshipi i Kroacisë", ka deklaruar Loxha.

Për liberalizimin e vizave për Kosovën foli edhe përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Joseph Borrell, i cili në fund të muajit të kaluar ishte për vizitë në Prishtinë. Ai tha se "nuk mund të garantojë asgjë pasi që vendimi merret nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian".

Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, shprehu zhgënjimin me mungesën e vendimit të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, duke thënë se "Kosova është padrejtësisht e anashkaluar, pasi Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret që nevojiten për liberalizim të vizave". Për tri vjet rresht liberalizimi i vizave për Kosovën ishte kushtëzuar nga BE-ja me ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Por edhe pse Kuvendi i Kosovës, ndonëse me tri vjet vonesë, arriti ta ratifikonte demarkacionin, BE-ja më pas nuk arriti konsensusin e brendshëm për t'ua hequr vizat qytetarëve të Kosovës.

Sot bëhen 13 vjet nga vrasja e Mon Balajt dhe Arben Xheladinit



PRISHTINË, 9 SHKURT - Sot (e hënë) bëhen 13 vjet nga protesta e 10 shkurtit e vitit 2007. Në nderim dhe kujtim të protestës, Lëvizja Vetëvendosje organizon disa aktivitete. Sot në orën 10:00 do të bëhen homazhe te varri i Arben Xheladinit në Prishtinë, ndërkaj në orën 12:00 do të bëhen homazhe te varri i Mon Balajt në Besianë. Po ashtu, në orën 13:00 do të bëhen homazhe te pllaka përkujtimore e dëshmorëve Arben Xheladini dhe Mon Balaj në bulevardin

"Nënë Tereza".

Trembëdhjetë vjet më parë, nën organizimin e Lëvizjes Vetëvendosje, u mbajt protesta ku kërkohej vetëvendosje, ndërsa policia e UNMIK-ut, konkretisht policët e regjimentit rumun dhe ukrainas, shtënë në me armë ndaj protestuesve, duke lënë të vdekur dy protestues dhe plagosur mbi 80. Nga kjo protestë e mbajtur 13 vjet më parë gjetën vdekjen dy aktivistët e LV-së, Mon Balaj dhe Arben Xheladini.

Kurti njoftohet me kërkesat e Grupit për Mbrojtjen e Liqenit të Badovcit

PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim përfaqësuesit e Grupit për Mbrojtjen e Liqenit të Badovcit, të cilët i prezantuan kryeministrit Kurti kërkesat e tyre në lidhje me mbrojtjen e liqeneve akumuluese gjithandë vendit, kundërshtimin e ndërtimeve afër tij dhe problemet e tjera ekologjike në përgjithësi. Ky grup ka kërkuar

takim me kryeministrin Kurti për t'i shprehur brengat dhe kërkesat e tyre në lidhje me këto çështje.

Si kryeministër i Republikës, Albin Kurti, ka thënë se dera e tij do të jetë gjithnjë e hapur, prandaj edhe i dëgjoi me vëmendje e kujdes kërkesat e këtyre qytetarëve. "Gjendja me ujën e pijes nuk është e qëndrueshme, prandaj edhe nevojia për liqene artificiale është e

madhe. U diskutua edhe për lumenjtë, brigjet e shtretërit e të cilëve duhet të rregullohen e pastrohen, problemin me shpyllëzimin e maleve, të hidrocentraleve dhe deponive të hapura të mbeturinave. Tema e ambientit është problem botëror. Shteti i Kosovës duhet të jetë mbrojtës i mjedisit dhe i resurseve natyrore të saj", është bërë me dije në njoftimin e qeverisë.



I jepet lamtumira e fundit bilbilit të Kosovës, Nexhmije Pagarusha

Në Pagarushë të Malishevës të dielën është varrosur këngëtarja e njohur Nexhmije Pagarusha, e cila ka ndërruar jetë të premtën në moshën 86-vjeçare. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës u bënë homazhe dhe më pas u mbajt një akademi përkujtimore për jetën dhe veprën e saj. Në këtë ceremoni morën pjesë politikanë e artistë nga vendi dhe rajoni. Në akademinë përkujtimore u tha se muzika dhe arti kanë humbur ikonën e tyre, kurse kombi ka humbur anëtarin më të dashur e më të çmuar



EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 SHKURT - Në Pagarushë të Malishevës është varrosur të dielën në mesditë këngëtarja e njohur Nexhmije Pagarusha, e cila ka ndërruar jetë të premtën në moshën 86-vjeçare. Në Teatrin Kombëtar të Kosovës të dielën u bënë homazhe dhe më pas u mbajt një akademi përkujtimore për jetën dhe veprën e saj.

Në këtë ceremoni morën pjesë politikanë e artistë nga vendi dhe rajoni.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në akademinë përkujtimore të Nexhmije Pagarushës ka thënë se muzika dhe arti kanë humbur ikonën e tyre, kurse kombi ka humbur anëtarin më të dashur e më të çmuar. "Nexhmija u lind në Pagarushë të Komunës së Malishevës në maj të vitit 1933 nga Nëna Sehide dhe babai Veseli.

Në moshën katërvjeçare Nexhmija do të humbte nënën, një ngjarje e rëndë që do ta prekte thellë Nexhmijen. Pa dashurinë e nënës jeta mund të jetë e ftohtë dhe e thatë, por mungesën e pranisë së nënës Nexhmija do ta kompensonte te babai Veseli, i cili ishte prindi, shoku dhe shkëmbi në jetën e saj që do t'i ofrojë Nexhmijes së re dashurinë dhe mbështetjen e nevojshme për rrugën e mundimshme që ajo kishte përpara. Shkollën fillore në Malishevë e gjimnazin në Prishtinë: në familjen e Veselit nuk kishin shumë të ardhura dhe e reja Nexhmije nuk kishte radio në shtëpi, por ajo merrte guximin për të kënduar. Dhe, këtu zë fill karriera e saj: këngën e kishte nisur si fëmijë, por karrierën e filloi më 1948 si këngëtare e Radio Prishtinës. Sapo i jepet mundësia për të kënduar, e reja Nexhmije ballafaqohet me realitetin e kohës

e që ishte turpi që një vajzë të këndonte në radio. E përballur me këtë trysni e padrejtësi të kohës, babai Veseli ishte aty për t'i ofruar mbështetjen dhe sigurinë e vetme që i duhej Nexhmijes përballë një bote mashkullore duke u bërë mbështetësi më i madh e adhuruesi i saj i parë", ka thënë Kurti, për të vazhduar se: "Në amanetin e saj, Nexhmija kërkoi që të varrosët në fshatin e saj të lindjes, afër babait të saj, duke treguar dashurinë e përrjetshme që ndjeu për të. Shembulli i Veselit na kujton edhe sot rolin dhe rëndësinë e pazëvendësueshme që ka babai në jetën e fëmijëve, e posaçërisht të vajzave që edhe sot përballen me diskriminim e paragjykim", është shprehur kryeministri Kurti.

Ai ka thënë se Nexhmije Pagarusha la pas vetes pesë albume e 88 këngë, secila më e mirë se tjetra. Kurse gjatë fjalës së saj, kryeparlamentarja Vjosa Osmani vlerësoi lart figurën e Nexhmije Pagarushës dhe trashëgiminë artistike që ajo la pas vetes. "Jam këtu para jush për ta ndarë dhimbjen e madhe për ndarjen nga jeta të bilbilit të këngës shqipe, Nexhmijes sonë, këngët e së cilës i kemi njohur e dashur qysh në rininë e hershme. Atëbotë nuk e dija se zëri im mund të dëgjohej në institucione dhe në politikë, por mahnitesha me këngën dhe, më shumë se me të, me atë që këngës ia jepte vullën e përjetësisë, me Nexhmijen, yllin që po e ndriçonte shpirtin e

secilës së re. Mahnitesha me mënyrën se si ajo reflektonte një forcë shtytëse për mua dhe shoqet e mia që të guxonim të ëndërronim që një ditë ta kapërcenim frikën e pasigurinë dhe të dëshmonim praninë tonë, ëndrën tonë, dëshirën për të jetuar në një shoqëri të lirë e të barabartë. Por, Nexhmija, megjithatë, i shtynte ëndrrat tona edhe më larg, shumë më larg: në krijimin e një bote që thyen konturat e një shoqërie të mbyllur dhe e bën atë të hapur, ndaj vlerave muzikore e artistike, ndaj botës së lirë", ka thënë Osmani, duke shtuar se për Nexhmijen nuk mund të thuhet asnjëherë se jetonte vetëm në një shoqëri e në një hapësirë ngaqë, siç tha Osmani, bilbili ynë i krijonte hapësirat, i zgjeronte ato, duke krijuar identitet të ri.

Ndërkaq presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se kudo që jetojnë shqiptarët, në Kosovë, në Shqipëri, janë zemërtier dhe të pikëlluar me vdekjen e Nexhmije Pagarushës. "Kujtimi për Bilbilin e Kosovës kurrë nuk do të zbehet dhe këngët e saj do të jetojnë përgjithmonë me ne", ka thënë Thaçi.

Pas kësaj ceremonie, kortezhi ka parakaluar nëpër sheshet kryesore të Prishtinës, në të cilin kanë marrë pjesë shumë qytetarë. Presidenti i Kosovës kishte shpallur të dielën (9 shkurt) ditë zie.

Nexhmije Pagarusha kishte lindur në maj të vitit 1933, kurse karrierën muzikore e kishte filluar në vitin 1948 në Radio Prishtinë. Pagarusha ishte nderuar nga Presidenca e Kosovës me çmimin "Artiste e Merituar", ndërkaq Presidenca Shqiptare e kishte nderuar me titullin "Nderi i Kombit".

Kënga "Baresha" konsiderohet një nga kryeveprat e interpretimeve të Pagarushës, e cila është realizuar në vitin 1966 nga kompozitori Rexho Mulliqi, me tekst të Rifat Kukajt. Ajo kishte përmbyllur karrierën si këngëtare aktive në vitin 1984 në një koncert në Sarajevë. Por, në vitin 2000, pas 16 vjetësh mungesë në skenë, ajo u rikthye duke kënduar për mediet shqiptare këngën "Për ty". Përveç muzikës, Pagarusha ishte edhe aktore e suksesshme si në film, po ashtu edhe në teatër. Ajo la pas vetes pesë albume dhe 88 këngë.



QKUK-ja konfirmon se nuk ka të sëmurë me koronavirus në Kosovë

EPOKA E RE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHKURT - Rezultatet laboratorike kanë treguar se pacientja e shtrirë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), nën dyshimet se mund të ishte e infektuar me koronavirus, kanë dalë negative. Pacientja e shtrirë në QKUK ishte shtetase e Britanisë së Madhe, e cila kishte shfaqur dyshime se ishte infektuar me virusin e ri. Dyshimet për paraqitjen e një rasti me virusin e ri në Kosovë e kishin shtyrë ministrin e Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovës, Arben Vitia, që të vizitonte Klinikën Infektive,

ku ai ishte zotuar se institucionet publike shëndetësore do t'i ndërmarin të gjitha masat e nevojshme. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike përmes një komunikate ka dhënë sqarim rreth këtij rasti. "Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK-së, se një paciente me nënshtetësi britanike është referuar nga Qendra Emergjente e Gjilanit për në Klinikën Infektive. Pacientja është staf ndërkombëtar në Kosovë dhe e njëjta ka qëndruar në një qendër skijimi në Mont Blanc, Francë, para disa ditësh. Pacientja është



vizituar nge ekipi i infektologëve në Klinikën Infektive në QKUK dhe në aspektin klinik ka pasur ethe të lehta dhe kollitje të lehtë. Menjëherë është marrë mostra për analizë laboratorike dhe është sjell për diagnostikë në

Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike. Ekipi i Laboratorit të Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK ka bërë testimin në novel koronavirus (2019 - nCoV) dhe në influencë A dhe B me metodën rRT-PCR.

Testi ka rezultuar negativ për të tri analizat, domethënë pacientja nuk është e infektuar me novel koronavirus (2019 - nCoV) dhe me influenza A dhe B", është bërë me dije në komunikatën e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Koronavirusi shkakton infektion të rëndë akut të frymëmarrjes dhe simptomat zakonisht fillojnë me ethe dhe kollë të thatë. Epiqendra e këtij virusi është në qytetin Vuhan të Kinës. Numri i viktimave në Kinë është rritur nga 86 në 722 të shtunën, sipas autoriteteve, derisa pritet ta tejkalojë rekordin e virusit SARS që shënoi 774 viktima.

Lekaj për autostradën e Anamoravës: 'Yrysh qeveria' po ngutet për t'i ndalë projektet që janë në të mirë të qytetarëve

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Ish-ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka komentuar çështjen e inicimit të procedurave ligjore nga ana e pasardhësit të tij, Lumir Abdixhiku, për anulimin e tenderit për autostradën të Gjilanit. Ai ka thënë se qeveria e re është duke u ngutur t'i ndalë projektet që janë në të mirë të qytetarëve. Sipas tij, një veprim i tillë i Abdixhikut është presion i drejtpërdrejtë ndaj zyrtarëve të prokurimit. "Po e shihni pra sesi 'yrysh qeveria' po ngutet t'i ndalë projektet që janë në të mirë të qytetarëve. Pra, po ngutet për ta hequr taksën, për ta penguar këtë projekt të madh për qytetarët e Anamoravës. Ky është një presion që po u bëhet zyrtarëve të prokurimit publik. Këta ose nuk e njohin sistemin, ose këto veprime po i bëjnë në mënyrë të qëllimshme dhe po e nxisin reagimin e qytetarëve", ka thënë Lekaj për "Epokën e re". Ai ka theksuar se qytetarët e Anamoravës kanë plotësisht të drejtë ta kundërshtojnë veprimin e ministrit Abdixhiku. Në këtë kontekst, Lekaj ka thënë se në ditët në vazhdim do të japë sqarime në lidhje me këto zhvillime brenda ministrisë të cilën e ka drejtuar deri para pak ditësh. "Mendoj se qytetarët e Anamoravës kanë plotësisht të drejtë ta kundërshtojnë një gjë të tillë sepse ne si Ministri e Infrastrukturës kemi ndjekur anën ligjore, duke u mbështetur në Ligjin e Prokurimit Publik dhe ministri nuk është ai që ndërhyr në prokurimin publik. Pra, nenet e atij ligji tregojnë se ministri nuk ka të drejtë të bëjë presion mbi zyrtarët apo të ndërhyjë dhe të ndalojë diçka që është ligjore. Kjo le të mbetet në natyrën e tyre. Unë si ish-ministër do ta sqaroj këtë çështje në detaje gjatë ditëve të ardhshme", është shprehur

Lekaj, duke shtuar se paralajmërimet dhe veprimet e qeverisë Kurti nuk janë mesazhe të mira për qytetarët. "Unë me marrjen e postit të ministrit nuk kam anuluar asnjë tender, edhe pse kam pasur të drejtë të kërkoj sugjerime dhe këshilla. Por, kam vazhduar rrugën institucionale për të ecur punët. Nuk ndryshon bota me ardhjen e kësaj qeverie në pushtet. Nuk ka ndryshuar bota as kur ne i kemi marrë përgjegjësitë qeverisëse. Jeta vazhdon. Mirëpo marrja e vendimeve të tilla në ditët e para, mendoj se është një mesazh i keq për qytetarët. Paralajmërimi për moszhvillimin e procedurave për autostradën e Dukagjinit dhe inicimi i procedurave ligjore për anulimin e tenderit në lidhje me autostradën e Gjilanit është një sulm për qytetarët e këtyre anëve", ka deklaruar Lekaj. Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, Lumir Abdixhiku, të premten ka kërkuar nga të gjitha departamentet përgjegjëse të ministrisë mundësinë e anulimit të tenderit 110 milionë euro për 24 kilometrat Banullë - Dheu i Bardhë. Në konferencë për medie ministri Abdixhiku ka treguar se ka pranuar dy opinione zyrtare nga dy institucione relevante, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik dhe nga Ministria e Financave e Qeverisë së kaluar, të cilat theksojnë qartë se pa alokim paraprak të mjeteve nuk mund të shpallen thirrje që krijojnë obligime financiare për Republikën e Kosovës.

Më tutje, ministri Abdixhiku ka shtuar se është e padëgjues që një qeveri në ikje, pa buxhet të aprovuar, ta fusë në obligime financiare qeverinë e ardhshme, që do të mund t'i kushtonin vendit me penalizime financiare që kanë ndodhur më parë. Ministri Abdixhiku ka siguruar qytetarët se projekti në fjalë do



të jetë prioritet i qeverisë së re. Duke qenë pjesë e programit qeverisës, thirrja për tenderim mund të ndodhë vetëm pasi të jetë miratuar buxheti i vitit 2020 dhe vetëm pasi t'i kuptojmë saktë mjetet financiare të alokuara për këtë qëllim.

Krahas kësaj, ministri Abdixhiku ka rikujtuar se qeveria e tanishme do t'i shqyrtojë të gjitha vendimet e marra nga qeveria e kaluar që nuk kanë bazë ligjore, me vëmendje të veçantë tek ato vendime me implikime financiare si këto.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka përshëndetur vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit për anulim të tenderit për autostradën e Gjilanit, për të cilën nuk ishin kalkuluar mirë kapacitetet financiare.

Shqipëria së shpejti me ligj për sektorin fintech



TIRANË, 9 SHKURT - Shqipëria do të ketë shumë shpejt një ligj të ri për shërbimet e pagesave, i njohur si sektori fintech. Ligjvënësit shqiptarë kanë nisur zyrtarisht procedurat e miratimit të ligjit në fjalë, që pritet ta nxisë konkurrencën në tregun e pagesave dhe të sjellë shërbime të reja. Linda Shomo, drejtoreshë e përgjithshme e kompanisë 'Easy Pay', duke shpjeguar risitë kryesore që do të sjellë ligji i ri në shërbimet e pagesave për qytetarët, thotë se

kompanitë e modelit fintech janë një realitet i rëndësishëm tashmë në shërbimet e pagesave. Shomo thotë se deri tani kuadri ligjor dhe rregullator nuk e ka favorizuar shumë zhvillimin e këtyre institucioneve financiare. Një studim i Bankës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore ka treguar se pagesat me vlerë të vogël kanë një kosto sa rreth 2.5 për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto ose pothuajse 300 milionë dollarë në vit. Kostot e mëdha lidhen shumë me dominimin e

parasë fizike si instrument pagesash në ekonominë shqiptare. Një zëvendësim gradual i pagesave cash me forma të tjera dhe kryesisht pagesa elektronike do të sillte kursime të konsiderueshme për ekonominë, veçanërisht për konsumatorët. Mbështetur në disa skenarë hipotetikë, zëvendësimi i 70 për qind të pagesave në formë letër me pagesa elektronike do të gjeneronte kursime në një vlerë sa pothuajse 1 për qind e prodhimit kombëtar.

Qeveria e Kosovës duhet ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik

PRISHTINË, 9 SHKURT - Qeveria e Kosovës duhet ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik, i cili garanton mirëqenie të qytetarëve dhe qeverisje stabile. Njohësit e fushës së ekonomisë thonë se disa nga sfidat që duhet të adresohen me urgjencë në planin e brendshëm nga qeveria e kryeministrit Albin Kurti janë: ndalja e emigrimit të të rinjve, zhvillimi ekonomik, rritja e punësimit, luftimi i korrupsionit si dhe fuqizimi i rendit dhe ligjit.

Qeveria e Kosovës gjithmonë ka proklamuar një program të

gjerë në aspektin socio-ekonomik, por veprimet deri tash nuk kanë qenë të tilla. Kështu thotë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, i cili potencon se prioritetet e politikave ekonomike duhet të janë të qarta dhe të matshme sidomos sa i përket hendekut të shkathhtësive dhe ikjes së trurit, rritjes të eksportit dhe investimeve të huaja direkte, sigurisë juridike për bizneset si dhe luftimit të informalitetit. “Rritja e migrimit apo ajo që është më e dëmshme për ekonominë duhet të jetë

prioritet, të mos kemi hendekun me fuqinë punëtore dhe me atë se çfarë ofron sistemi arsimor. Duhet një qartësi për sa iu përket politikave për investime dhe për eksport, një punë e përbashkët e bashkëpunimit të çështja e informalitetit. Duhet që Kosova ta ketë të qartë të ardhmen e vet energjetike dhe duhet të angazhohemi që Kosova të krijojë vende pune të qëndrueshme”, ka thënë ai.

Po sipas Aleancës Kosovare të Bizneseve, ekonomia është çelësi i çdo suksesi nëse ajo është në zhvillim e sipër.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, thotë për “Radio Kosovën” se deri tani ka vazhduar trendi i pakënaqësive sociale dhe i atyre që duan ta lëshojnë Kosovën. “Deri më tani statistikisht tregojnë se ekonomia e vendit ka shënuar rritje rreth 4 për qind, por edhe ka vazhduar trendi i pakënaqësive sociale, rritja e kërkesave të atyre qytetarëve që duan ta lëshojnë Kosovën. Dhe kjo do të duhet të jetë një prioritet për qeverinë Kurti, nëse do të ketë politika nxitëse zhvillimore të investimeve qoftë vendore apo të huaja, në mënyrë që të rriten investimet,

eksporti dhe të ndalen migracionet për të cilën është rrezik se një ditë Kosova do të mbetet e zbrazët”, ka thënë ai. Edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë thotë se qeveria Kurti duhet të garantojë një ekonomi të lirë të tregut si dhe një mjedis të barabartë, i cili do t'i lejojte investitorët vendorë dhe të huaj ta shfrytëzonin potencialin e tyre për një rritje të përshpejtuar ekonomike, e cila do të ndihmonte në krijimin e vendeve të reja të punës dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve.



Bashkia e Tiranës jep dëmshpërblimin për 302 familje të prekura nga tërmeti



TIRANË, 9 SHKURT - Bashkia e Tiranës ka vazhduar të japë dëmshpërblime për të prekurit nga tërmeti shkatërrues i 21 shtatorit. Krahas rindërtimit të të gjithë banesave të shkatërruara plotësisht nga tërmeti, Bashkia e Tiranës ka vazhduar edhe dhënien e dëmshpërblimit për ato familje të prekura nga tërmeti i 21 shtatorit. Këshilli Bashkiak ka miratuar listën me emrat e 302 familjeve që kanë pësuar dëme ndërtimore si pasojë e tërmetit të datës 21 shtator 2019 dhe përmblyes së 23 shtatorit 2019,

ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore.

Drejtoria e Emergjencave Civile në cilësinë e strukturës përgjegjëse për mbrojtjen civile, në nivel vendor, ka plotësuar dhe verifikuar dokumentacionin në të gjithë territorin e Bashkisë së Tiranës, raporton “TCh”. Pas përfundimit të punës në terren, stafi i njësive administrative në bashkëpunim me qytetarët ka plotësuar dosjet për secilin prej tyre me dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor dhe i ka përcjellë pranë Drejtorisë së Emergjencave Civile, për t'i

hapur rrugë procesit të vlerësimit të këtyre praktikave.

Pas verifikimit të dosjeve për saktësinë e dokumentacionit, Drejtoria e Emergjencave Civile i ka përcjellë për vlerësim në Këshillin e Qarkut Tiranë.

Për shkak të situatës emergjente të krijuar, është punuar me orar të zgjatur dhe për një pjesë të praktikave ka përfunduar edhe procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve në Këshillin e Qarkut, të cilat janë përcjellë nga ky institucion në Drejtorinë e Emergjencave Civile, Bashkia Tiranë.

Përkujtohet veprimtari i çështjes kombëtare, Ramadan Emini

FERIZAJ, 9 SHKURT (ER) - Në teatrin "Adriana" në Ferizaj është përkujtuar veprimtari i çështjes kombëtare, Ramadan Emini. Në mesin e qindra qytetarëve, shtetarëve, drejtues e përfaqësues të institucioneve publike e shoqërore, shoqatave të luftës së UÇK-së e të burgosurve politikë, i pari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se veprimtari Emini ka bërë shumë për Kosovën. "Këto dërrasa teatri shumë herë u shkelën, jo për art. As për gëzime. As për festa. Këmba jonë qindra herë rëndoi mbi kurrizin e drunjte, për ta përkthyer lotin në fjalë. Dhembjen në forcë e krenari. Edhe sot është njëloj. Aty prapa qëndron e na sheh edhe nga lart, veprimtari që merr kuptim të plotë të fjalës, vetëm pak po ta gërvishim historinë që barti ky

burrë mbi supë. Është Ramadan Emini, është fytyra që pulson sakrificën e bërë njësh me krenarinë. Është vëllai i dashur e i përkëdhelur i më të shtrenjtës heroinë që i dhamë Kosovës, Hyrë Emini. Ai ishte babai që mundi vuajtjen, trishtimin e zemrën e bërë copë nga e ashpra vdekje që i mori më të dashurit. Do të mbetet ikona dalluese e qytetit, që papërkulshëm, dinjitetshëm siç pati në gjene të familjes, ecjen vertikale, krenarinë që i mbushte gjoksin e zbehjen e lehtë që i venitej mërzia dallueshëm fytyrës. Lart në qiell jetojnë engjëjt. Vallja e vdekjes kapërdiu edhe Danin. Është Hyra ajo që e pret krahëhapur të vëllanë, është Kosova ajo që deshën, jemi ne, që gjithmonë do t'i mbajmë në zemër", ka thënë Aliu.



Haziri merret vesh me delegacionin zviceran për ta bërë atraktive shkollën e agrobiznesit

GJILAN, 9 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim një delegacion zviceran të kryesuar nga Daniel Wafler, deputet i Parlamentit të Cyrihut, i cili shoqërohej nga Karl Kupper, profesor në shkollën e Agrobiznesit Strickhot të Cyrihit, Zija Shabani, afarist dhe Florina Wafler, bashkëpunëtore.

Në këtë takim kanë marrë pjesë edhe drejtorët komunalë, Ramiz Ramadani e Valbona Tahiri, si dhe drejtori i Shkollës së Mesme të Agrobiznesit "Arbëria", Xhelal Jetishi. "I falënderoj shumë për vizitën në Gjilan. Vizita ka të bëjë me mbështetjen ndaj Gjilanit dhe



regjionit tonë. Në fokus të bashkëpunimit tonë është Shkolla e Mesme e Agrobiznesit 'Arbëria'.

Drejtorja e Bujqësisë dhe ajo e Zhvillimit Ekonomik do të angazhohen sa më shumë që ky

program të jetë në fokus në mënyrë që fëmijët, nxënësit e studentët ta shohin shkollën e agrobiznesit si derën kryesore për punësim në të ardhmen", ka deklaruar kryetari Haziri pas takimit.

Ai ka thënë se agrobiznesi dhe bujqësia janë dera kryesore që në të ardhmen e shohin zhvillimin lokal ekonomik. "Qëllimi është që shkolla 'Arbëria' të bëhet atraktive për mesimdhënësit dhe nxënësit, sikurse shkolla e pasdites për nevojat e fermerëve, për rritjen e produktivitetit dhe nxjerrjen e produkteve në tregun evropianë", ka deklaruar ai.

Ndërsa Daniel Wafler, deputet i Parlamentit të Cyrihut, ka thënë se kanë ardhur me delegacionin zviceran për ta ndihmuar sistemin e arsimit, përkatësisht shkollën e mesme të agrobiznesit. "Ideja është që atë që e kemi në Zvicër, pra përvojën, ta bartim në Gjilan, në sistemin e arsimit. Do ta krijojmë një bashkëpunim të fortë. Përvoja jonë do t'ju ndihmojë që ta krijojmë në agrokulturë të fortë e me sukses", ka thënë Wafleri. Delegacioni zviceran ka vizituar edhe dy brendet e njohura të Anamoravës, "Lura" dhe "Moea", të cilët kanë parë nga afër punën që bëhet aty.

Nënshkruhet marrëveshja për mbështetjen e 30 bizneseve në Podujevë



PODUJEVË, 9 SHKURT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari dhe drejtoresha e organizatës gjermane "Help", Shqipe Breznica, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të projektit për mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë. Marrëveshja e nënshkruar ka për

qëllim vendosjen e bashkëpunimit në mes të Komunës së Podujevës dhe organizatës "Help" për bashkëfinansim në kuadër të projektit "Mbështetje stabiliteti socio-ekonomik në Kosovë", i financuar nga Medicor Foundation dhe zbatuar nga "Help". Projekti do të realizohet deri në

muajin korrik të vitit 2021 dhe Komuna e Podujevës do ta bashkëfinancojë projektin, i cili fokusohet në ofrimin e mbështetjes dhe përkrahjes ekonomike dhe zhvillimit lokal. Në kuadër të këtij projekti do të mbështeten materialisht të paktën 30 biznese si dhe në organizimin e trajnimeve profesionale.

Pesë familje skamnore nga Skenderaj bëhen me shtëpi

SKENDERAJ, 9 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me humanistin hoxhë Halil Kastrati nga Shoqata "Jetimat e Ballkanit", kanë dhuruar çelësat e shtëpive edhe për pesë familje të tjera në nevojë nga kjo komunë. "Shoqata 'Jetimat e Ballkanit' në bashkëpunim me Komunën e

Skenderajt iu kanë dalë në ndihmë dhjetëra familjeve në nevojë nga Skenderaj, duke iu ndërtuar shtëpi dhe dhuruar banesa, gjë për të cilën kryetari Bekim Jashari u shpreh jashtëzakonisht falënderues ndaj kësaj shoqate humanitare e cila, sipas tij, po i buzëqeshë shumë familje në nevojë. Familjet përfituese të pesë

shtëpive që u ndanë janë: Xhemë Xhokaj, pesë anëtarë nga fshati Llaushë; Mehmet Hoxha shtatë anëtarë, Llaushë; Nuredin Meha, pesë anëtarë, Prekaz i Poshtëm; Ferat Berisha, katër anëtarë, Kryshec; dhe Hasan Hajrizaj, katër anëtarë nga fshati Abri e Poshtme", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.



Çfarë do të ndodhë me shqiptarët në Maqedoninë e Veriut?



Arsim SINANI

Në vorbullën politike që po kalojnë shqiptarët s'do mend se një lodhje të mirëfilltë kanë shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në veçanti. Edhe pas më shumë se tri dekadash nuk po arrijnë ta gjejnë formulën politike për t'iu kundërvënë aparatit shtetëror maqedonas tek i cili hyjnë e dalin si spektatorë.

Në një situatë të këtillë u pa se në dy ciklet zgjedhore janë prishur balancat për shkak të partive shqiptare në pushtet (BDI, PDSH, ALTERNATIVA) që nuk ofruan asgjë nga programi politik i shqiptarëve këtu dhe ruajtën vetëm ekzistencën e tyre politike dhe asgjë më shumë.

Shkapërderdhja politike është një doktrinë e ngritur bukur nga establishmenti politik maqedonas që shqiptarin në sistem e mban mirë, por pa doktrinë shqiptare. Thjesht, si një instrument karshi ndërkombëtarëve. Mos etablimi në dy blloqe politike i partive shqiptare në Maqedoni të Veriut ka shumë gjasa që të prodhojë atë që ndër vite nuk ka arritur ta bëjë doktrina shtetërore maqedonase, që shqiptarët të votojnë për një parti maqedonase. Dhe pa një marrëveshje mes partive shqiptare këtë do ta shfrytëzojnë me elegancë socialdemokratët maqedonas, të cilët shansin e tyre e shohin te votuesi shqiptar, i cili është mjaft i dëshpëruar nga gënjeshttrat që ia kanë servuar partitë shqiptare, e në prapaskenë të dirigjuara nga maqedonasit. Këtë shqiptarët e kanë kuptuar shumë mirë, por fati i keq është se shpresat i janë prerë pasi elitat politike shqiptare në Maqedoni të Veriut, në veçanti te shqiptarët,

janë elita të përzgjedhura nga maqedonasit e brenda partive politike shqiptare. Kjo me gjasë do të shfrytëzohet me shumë kujdes nga socialdemokratët që e duan me çdo kusht fitoren në zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Mosunifikimi i opozitës shqiptare Lëvizjes Besa dhe Aleancës së Shqiptarëve është lajm i keq për votuesin shqiptar, i cili do ta ndëshkojë miksturën e partive politike shqiptare në qeveri. Kjo realisht i shërben doktrinës maqedonase, e cila do që ta zgjidhë njëherë e mirë problemin me shqiptarët duke ua marrë të drejtën kombëtare që të kenë përfaqësim dinjitoz. Edhe pas dy dekadave të konfliktit shqiptaro-maqedonas elita politike shqiptare që doli nga lufta pa kuptim e humbi fletoren e idealeve mes Shkupit e Tetovës dhe i tjetërsoi e zvetënoi kërkesat e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut. Nga shtetformësia apo siç e them në vazhdimësi, shqiptarët duhet të jenë themelartë të vendit, e në vend të kësaj kjo kastë

përfundoi në zyrat e Shkupit duke i zgjidhur problemet e një grupi njerëzish të dyshimtë që u imponuan dhe e tjetërsuan idealin e shqiptarëve të Maqedonisë. Lufta politike tanimë në kampin politik shqiptar e ka humbur kuptimin e vet dhe shpresat mbeten në një lëvizje të mirëfilltë politike shqiptare kundrejt aparatit shtetëror që ta pranojë shqiptarin si themelart, por këtë betejë do të duhet ta zhvillojë një gjeneratë e cila nuk është pjesë e kalkulimeve të sotme politike. Shqiptarët në Maqedoni të Veriut nuk e meritojnë këtë gjendje në të cilën janë katandisur, por këtu mbështetja e politikës shqiptare në rajon ka qenë e paqartë dhe vetëm se e ka përkeqësuar këtë gjendje.

Si ka mundësi që shqiptarët mos të merren vesh mes vete dhe ta kërkojnë qenien e vet brenda një subjekti politik maqedonas. Kush i katandisi kaq keq?! Dhe shumë pikëpyetje të tjera të cilat jo se nuk kanë përgjigje, por s'ka formacion i cili e zhvendos

betejën në këto çështje, pasi pushteti jo vetëm që i ka tjetërsuar, por edhe i ka tenderizuar shqiptarët në pushtet.

Në zgjedhjet e fundit presidenciale shqiptarët nxorën një kandidat dinjitoz presidencial, profesorin e nderuar Blerim Reka, i cili e unifikoi opozitën shqiptare në një Besëlidhje, siç e quajti ai por, fatkeqësisht, nga distanca e sotme kohore po shihet se partitë politike shqiptare në Maqedoni të Veriut janë pa vizion politik dhe kontinuitet në veprime, prandaj edhe janë kështu siç janë sot, pa një drejtues të mirëfilltë politik.

Çështja e servilosjes politike e krerëve politikë shqiptarë kundrejt elitës politike maqedonase është një çështje që kërkon analizë të thellë, pasi pranvera shqiptare në Maqedoni të Veriut do të vonohet për aq kohë sa të konsolidohet kreu i ri i Qeverisë së Kosovës, Albin Kurti, i cili shihet si shpëtimtari i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.

Pesë shembuj nga qëndresa e Drenicës në luftën e komandantit Shaban Polluzha



Ismail SYLA

Më 8 shkurt 1945 nga establishmenti i lartë politik dhe ushtarak jugosllav në Kosovë shpallet gjendja e jashtëzakonshme - administrimi ushtarak - një dokument që krijoi bazën juridike për të vrarë, prerë, likuiduar dhe shkatërruar gjithçka në Kosovë, për të mënjeluar fizikisht çdo patriot që kundërshton Jugosllavinë komuniste në ardhje, që me antishqiptarizëm nuk dallonte nga Jugosllavia e mëparshme monarkike. Në fakt, në thelb të çdo gjëje kundër Kosovës ishin përfaqësuesit politikë dhe ushtarakë serbë të Beogradit zyrtar.

Duke lexuar shifra dhe fakte të periudhës dhjetor 1944 deri më 21 shkurt 1945 për vrasje, p. sh., vetëm në rajonin e Drenicës, njeriu tmerrohet edhe sot.

Që lexuesi të mos ngarkohet në një postim "Facebook"-u me historinë e krimeve, këtu do të

veçoj disa momente për mua interesante, në kohën kur rezistoi komandanti Shaban Polluzha me bashkëluftëtarët e tij në Drenicë, bazuar në rrëfimet që i mbledh autori Azem Hajdini.

1. Zhbllokimi i armëve.

Në vijën e frontit Gllavicë - Shtuticë - Dashefc, Kralicë dhe Prelofc intensiteti i luftës nga të dy anët e frontit ishte shumë i madh, përderisa, nga acari i madh që mbretëronte ato ditë filluan të ngrihen tytat dhe mekanizmat tjerë të armëve. Për t'i pasë ato gjithnjë në gjendje gatishmërie, gratë dhe vajzat ndezën zjarre në vende të caktuara dhe përgatitnin ujë të valë për t'i zhbllokuar ato.

2. Ilaçet popullore për të plagosurit.

Për gjendjen shëndetësore të të plagosurve kujdesej përveç tjerësh, edhe Osman Hajdini, bashkë me Dinoren, nënën e tij, jo vetëm pse ishte zot i konakut, por edhe për shkak se ishte njohës i mirë i përpunimit dhe përgatitjes së disa llojeve të barërave për shërimin e plagëve, të cilat shërbenin si "melheme" të marra nga druri i shtogut, yndyra e lepurit, tëlyeni i buallicës, kokrra e fasules etj.

3. Fëmijët me qerre - saja, bartin kufoma.

Pasi që forcat e armikut kishin ripushtuar Dashefcin, Shtuticën dhe një pjesë të Polacit, komanda e atyre njësiteve (kupto - serbe) organizoi aksionin për hulumtimin, grumbullimin dhe bartjen e kufomave të ushtarëve të vrarë, të cilët tashmë i kishite mbuluar bora e madhe që binte ato ditë dimri pa pushim. Në këtë aksion, përveç ushtrisë, me dhunë ishin mobilizuar edhe fshatarët, bile edhe fëmijët shqiptarë.

4. Toponimi "i ri".

Pas luftës, rezistencës dhe shuarjes së kryengritjes së bashkëluftëtarëve të Shaban Polluzhës, administrata komunale bëri një emërtim interesant në terrenin kadastral të fshatit Dashefc. Mikrotoponiminë e fshatit e regjistroi me një emërtim tjetër, sllav... Kështu, p.sh. toponimet Lugu i Dhëlpnave, Lugu i Lajthive, Lugu i Hasan Lekës etj. në librat e kadastrit më vonë kanë marrë emërtim të ri "Krvave Poljane" që në shqip do të thotë "Fushat e Përgjakura".

5. Hapja e frengjive të reja dhe varrosja te dera e oborrit.

Gruaja me emrin Ajmane kujton:



"Në shtëpinë tonë u çelën shumë frengji...", si adaptim ad hoc i kullës për të rezistuar nga brenda. Po kjo grua i ndihmon në mirëmbajtje të armëve luftëtarit Asllan Kolla, i cili lufton përballë forcave serbe me mitraloz nga një frëngji e re brenda kullës, por

vrivet. "E ktheva mbarë dhe e mbulovala me një çarçaf të bardhë. E varrosëm te dera e oborrit dhe aty qëndruan eshtrat e tij plot 20 vjet" përfundoi rrëfimin e saj Ajmania, sipas shënimeve të Azem Hajdinit.

6. Etj., etj...

Enciklopedi për Çamërinë

(Ibrahim Daut Bejdeshati (Hoxha),
ÇAMËRIA - shtegtim nëpër Shqipërinë e
Jugut, botoi ALSAR, Tiranë, 2019, f. 923)

Mehdi GURRA

Përpara se të flasim për enciklopedinë e botuar mbi Çamërinë, duhet thënë dhe diçka më tepër për këtë krahinë shqiptarësh në pjesën më jugore të banuar prej tyre. Fjalori Enciklopedik Shqiptar thotë se Çamëria shtrihet përgjatë bregdetit të Jonit, nga lumi i Pavllës (ose i Shalësit) në veri deri në gjirin e Prevezës në jug, në gjatësi rreth 107-108 kilometra, ndërsa në lundje shkon deri te malet e Kurillës dhe te shkalla e Parathimisë, me një sipërfaqe prej rreth 3900 km², ku mbizotërojnë kodra e male me lartësi jo më tepër se 1000 metra. Filati, Gumenica, Lurai, Margëllëçi, Arta, Parathimia, Parga dhe Preveza njihen si qendrat kryesore të Çamërisë. Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913 la brenda kufijve të shtetit shqiptar vetëm fshatrat Dishat, Janjar, Konispol, Markat, Ninat, Shalës dhe Vërvë me popullsi muslimane, dhe Çiflik, Mursi e Xarrë me popullsi ortodokse.

Çam e Çamëri kanë lidhje me emrin antik të lumit Thyamis, që kalonte nëpër territorin e Tesprotisë, banuar prej fisit ilir të Tesprotëve. Çamëria ishte pjesë e sanxhakut të Delvinës dhe Janinës gjatë periudhës osmane. Popullsia në atë kohë sillet sipas botimit të përmendur më lart nga 95 në 110 mijë banorë. Andartët grekë iu sulën Çamërisë më 1854 dhe 1878, pritur me armë nga popullsia vendase. Atë që nuk e bënë ata e realizoi sa hap e mbyll sytë Konferenca e Ambasadorëve e 1913-s. Pas Luftës së parë Botërore, qeveritë greke dëbuan për në Anadoll mijëra çamë muslimanë. Dëbimet greke do të vijonin dhe në fundin e Luftës së Dytë Botërore.

Dëshmive të fatit tragjik të Çamërisë dhe të çamëve si një popullsi e persekutuar, e padëshiruar dhe e dëbuar prej trojeve të veta, u është shtuar pak kohë më parë një vepër enciklopedike, e botuar nga Fondacioni ALSAR. Botimi vjen si një shprehje e politikës së dyerve të hapura të Fondacionit ALSAR për ato vepra dhe ata autorë që trajtojnë tema të çështjes kombëtare. Përkujdesi i fondacionit për t'i botuar të tillë vepra është i vazhdueshëm, si konkretizim i vizionit të tij atdhetar.

Ibrahim Daut Bejdeshati (Hoxha), si bir i Çamërisë, bir i një dere të njohur çame, i ka kushtuar vite të tëra të jetës së vet mbledhjes së materialeve historike për tokën që e lindi, përpilimit të një teksti të boll-

hëm, të finalizuar me botimin e veprës "Shtegtim nëpër Shqipërinë e Jugut: Çamëria".


Në krye të 923 faqeve të enciklopedisë ndeshen tre citate prej nga duket se e ka marrë frymëzimin autori për ta kthyer në fjalë të shkruara mundin e tij shumëvjeçar: "Një komb që nuk njeh të kaluarën e vet, ja është fëmijë, ja i pamend. Një komb që e përbuz atë, është i humbur!", "Një komb që nuk din të kaluarën e vet, është i vetëdënuar të vuajë mjerimet e së kaluarës së tij!", "Për fajë të botës, shqiptarët ngrenë këmbët, i bien kokës!"

Vëllimshkruesi, siç e quan veten autori, përdorues i një shqipeje të pasur, e shpjegon me katër rreshta në hyrje se ç'është kjo vepër enciklopedike, ku na thotë se ajo bën fjalë për ilirët jugorë skajorë, të quajtur shqiptarë prej mbi 300 vjet, për vendet e tyre stërgjyshore, për mëmëdhetarinë dhe vendmbrojtësinë e tyre shembullore, për cilësitë e dalluara luftarake dhe për ndodhi të shënuara në jetën në trevat e tyre.

Emra, vende, ngjarje, karakteristika, shkolla, objekte kulti, organizata, shoqata, harta dhe fotografi, këmbyer faqe pas faqeje, na bëjnë të njohur një Çamëri tepër të pasur në histori, tepër të begatë, po ashtu, në fund, tepër të pafat për banorët që i mbanin gjallë emrin.

Zëri i kushtuar Çamërisë në vepër merr më shumë faqe se çdo zë tjetër. Prej aty vlen të japim këtu paragrafin e parë, më të rëndësishmin për të kuptuar dramën e atyre njerëzve: "Çamëria është pjesa më jugore e trungut tokësor shqiptar. Më 10-13 mars 1913, pas 6 muajsh mbrojtjeje vetëmohuese (18. X. 1912 - 7. 3. 1913), përfundoi në thonjtë e njëjësive ushtarake mësyse greke. Vitin e pushtimit (1913), Çamëria e tërë banohej nga rreth 120.000 banorë, shumica dërrmuese shqiptarë. Përfaqësuesit e shteteve të mëdha evropiane asokohe - si edhe tjetër herë - i vunë sëpatën; nëpërmjet Konferencës së mallkuar të Ambasadorëve, më se 5/6 e saj së toku me vendësit e vet i vunë nën zgjedhën më të rëndë dhe më të urreyer, nën atë të pushtetarëve kryqtarë athinofanaritë. Këta shkelën haptazi pa kurrfarëndrojtjeje çdo të drejtë njerëzore e kombëtare si dhe çdo kusht e marrëveshje ndërkombe. Gjatë 42 vjetëve sundimi përpinë tërë ata çamër, që e njihnin veten shqiptarë, përpiqeshin të mбетeshin të tillë, që bënin çmon të shpëtonin veten, mallin dhe vendin e vet nga ajo robëri aq e zezë."

Emërtimet, vendndodhja, për-



katësia, caqet, lashtësia, ndarjet administrative shtetërore, lartësitë, qafat, gravat, sheshinat, burimet, kronjet, përrënjtë, lumenjtë, liqenet, detet, cepat anëdetarë, gjiret, portet, ujdhezat, klima, bimësia, bota shtazore, ekonomia, blegtoaria, bujqësia, zejet, tregtia dhe tregjet, rrjeti rrugor, çamërit nërrjedhën e ngjarjeve historike, veshjet, bindjet fetare, cilësitë dhe veçoritë morale, etj., janë nën zëra që e bëjnë të plotë përshkrimin e Çamërisë.

Në enciklopedi gjejmë të dhënë jetën fetare të çamëve, numrin e xhamive në qytetet kryesore, emrat e tyre, të atyre që i ndërtonin, të medreseve, si atë, për shembull, të Konispolit, një zë apo nënzë u kushtohet arvanitëve, flitet për hebrenjtë në Çamëri e Janinë, tregohet për udhëtimin e Evilja Çelebiut nëpër Çamëri e Mollosi, merret në analizë femra çame dhe pozita e saj sipas moshës dhe gjendjes civile, kritikohen vepra të mëhershme për Çamërinë, si "Historia e Çamërisë" e Kristo Frashërit.

Në lidhje me periudhën osmane, autori thotë: "Sapo Çamëria u vu në përbërjen e sulltanatit osman, ashtu sikur edhe Janina e krahinat e tjera mbarëshqiptare, për të parën herë në udhëtimin e tyre historik e parahistorik u përmbledhën në një njësi të vetme me emrin 'Arnavutluk'."

Për të njëjtën periudhë, të nxirë si mos më keq prej lloj-lloj historianësh të prekur nga viruse ideologjizmesh gjithfarësh, ai shprehet në faqen 838 se, "burimet e mirëfillta historike na bëjnë të ditur se gjatë gati të 500 vjetëve të sundimit osman - që në të vërtetë, siç dëshmohet pa kurrfarë mëdyshjeje, ishte sundimi i përbashkët turko-arbëror - arbërit dhe pasuesit e tyre, shqiptarët, qëndruan vendosmërisht me vetëdije brenda sulltanatit osman; këtë domosdoshmëri jetike qeveritë fuqiplote evropiane - dashamirëse të grabitqarëve fqinj - me veprime të paudhta gjatë mëse 100 vjetëve ia dolën ta asgjësonin. Është krejtësisht e ditur se arbërit me turqit u vëllazëruan e - siç do të

shihet - dhe gati u bënë një me ta. Kjo pashmangshmëri kryekëput e domosdoshme ndodhi ngaqë - siç e thashë dhe gjetkë - ishin plotësisht të vetëdijshëm se arbërit dhe turqit përballë kishin të njëjtë armiq."

Ibrahim Daut Bejdeshati (Hoxha) është i biri i Daut Hoxhës, vrasja e të cilit u përdor për të nisur luftën italo-greke të vitit 1940. Edhe pse vështrësitë dhe telashet nuk iu ndanë tërë jetës, Ibrahim Daut Bejdeshati (Hoxha) nuk reshti së kërkuari dhe së shkruari për Çamërinë. As mosha e thyer nuk ia ndali vrullin. Dhjetëra libra janë nxjerrë prej duarve të tij si autor dhe bashkautor, përpos qindra kumtesave dhe shkrimeve të mbajtura e të botuara ndër vite. Në duhet përmendur një veçori në këtë vepër të botuar së fundi, "Shtegtim nëpër Shqipërinë e Jugut: Çamëria", ajo është gjuha shpatë e tij, e ashpër dhe e prerë për atë që ai mendon se e meriton. Ky çam i kulluar kështu flet!

(Autori është kryetar i Fondacionit ALSAR të Tiranës)

VIZIONI PËR JETËN DHE ARDHMËRINË

(Lutfi Dervishi, "Violina e humbur", LShK, Prishtinë, 2019)

Shyqri GALICA

Emrin e pedagogut dhe mjekut Lutfi Dervishi tashmë pothuajse e kemi të njohur. Pos si mjek të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, prof. dr. Lutfi Dervishin shumë prej nesh e njohim edhe si pedagog të Fakultetit të Mjekësisë të universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", i cili ligjëron lëndën kirurgji që disa vjet. Në fushën e shkencës së mjekësisë ka botuar disa studime e tekste universitare dhe ka marrë pjesë në tubime të ndryshme shkencore brenda e jashtë vendit, kurse profesionin e urologut pesë vjet e ka ushtruar edhe në Gjermani.

Një dinamikë herë spontane, herë provokuese, herë kërkuese

Ndërkaq, në fushën e letërsisë ka bërë hapat e parë herët, që në vitin 1966, duke botuar vjershën e parë në "Rilindjen për fëmijë" dhe më pas nëpër revista e gazeta të tjera, si "Flaka e vëllazërimit", "Shëndeti", "Pionieri" e "Zëri i rinisë". Por, pas shumë kohësh do t'i kthehet artit të letërsisë me krijime të tjera. Para pak kohësh doli para lexuesit me romanin "Violina e humbur", botim i LSHK-së, duke trajtuar tema që ndërlidhen me realen dhe imagjinaren, kundruar nga një kënd i mëvetësishëm krijues e intrigues, ngjarje që deri në fund mban të gjallë kërkuesin e lexuesit, madje me një dinamikë herë spontane, herë provokuese, jo rrallë edhe kërkuese, duke synuar një botë shqetësimesh e dramash deri në tragjedi, të cilat përjetojnë nëpërmjet jetës së artistit Jon Dreni, që ka tri dashuri: violinën, vajzën Rona dhe dashurinë e dashurisë!


Ngjarja zhvillohet në linjën Prishtinë - Vjenë - Tiranë. Personazhi kryesor, violinisti Jon Dreni, bie nëpër situata tejet të rënda dhe gjen rrugën për të dalë sërish në sipërfaqe të paraqesë talentin e jashtëzakonshëm edhe në skenën e Vjenës dhe më gjerë. Dashuria e tij për violinën, për të bijën Ronën dhe për dashurinë si instinkt dhe shpirt,

personazhin e tij e bën tejet funksional dhe të ndërgjegjshëm për jetën që duhet ta ketë çdo njeri që ka shpirt artisti dhe vizion për jetën dhe ardhmërinë...

Rrjedha e dramës në këtë roman zhvillohet në kontekst të ngjarjeve aktuale, por në shumë aspekte trajtohen edhe anë profesionale, që autori i shtrin aq natyrshëm, sa që krijohet përshtypja se dhe ti je pjesëmarrës i situatave dramatike dhe i botës komplekse që ndërtohet në dimensione të ndryshme. Është artisti që futet në botën e një instrumenti muzikor, madje të instrumentit më karakteristik, violinës, që e ndien dhe e përjeton si shqetësim artistik e jetësor deri në dimensionin e ekzistencës. Situatat që ndërtohen në vepër, ngjarjet plot dramë e kthesa, e ndalin receptuesin të presë me kërkuesin veprimet e tjera, që shpesh dalin të papritura, komplekse dhe që kërkojnë zgjidhje jo avash-avash, por me një dinamikë që autori di ta zgjidhë, duke lënë hapësirë për të menduar më tej për zhvillimin e tyre në kontekst të ngjarjeve dhe të vendeve ku zhvillohen ato.

Romani kërkon kohë e përqendrim

Po dhe trekëndëshi nga lëvizin ngjarjet - Prishtina - Vjena - Tirana shquhet me simbolikën aktuale të lidhjeve që pretendojmë si komb për t'u inkuadruar në botën moderne, në mjedise ku dhe njeriu ynë mund të shquhet me talentin e tij, me prirjet rezatuese e dalluese, me gjithë pengesat që i sjell jeta dhe papërgjegjësitë e pushtetarëve për ta frenuar vullnetin e një profesionisti për të dhënë ndihmesën e vet në mjedise të qytetëruara. Në këtë kontekst, në mjaft situata autori paraqet edhe veprimet e medieve dhe të përfaqësuesve të tyre, që dalin jo vetëm joseriozë, por në shumë rrethana edhe palaço, të cilët diskreditojnë atë që nuk mund të diskreditohet, fyejnë atë që nuk mund të fyhet, ngacmojnë ndjenjat dhe shqetësojnë jo vetëm individin, por dhe publikun, që detyrohet të ndjekë rrjedhën e ngjarjeve e ta paraqesin në kontekst tjetër. Këtë fakt sigurisht autori ka



pasur rast ta përjetojë në lëkurën e vet dhe ka arritur ta artikulojë bindshëm në roman në rastet kur si personazhe dalin mediet, madje pa i specifikuar. Faktikisht dihet se "Violina e humbur" është roman i një

krijuesi që po bën hapat e parë në këtë fushë, madje në fushën më serioze të krijimtarisë letrare, por që jep mundësi për një qasje të gjerë dhe që kërkon përkushtim të veçantë, sidomos kur të kihet parasysh dhe

vëllimi, që autori i ka kushtuar shumë kohë e përqendrim për të artikuluar në linja të ndryshme ngjarjet e veprës dhe për të krijuar një përvojë sado modeste në krijimin e kësaj gjinie.

E jashtëzakonshme

Me maska në fytyrë, koronavirusi nuk i ndalon mijëra çifte të martohen në Korenë e Jugut

Mijëra çifte u martuan në një kishë të premtën që lamë pas, me gjithë shqetësimet në Korenë e Jugut për përhapjen e shpërthimit të koronavirusit. Kisha e themeluar nga Sun Myung Moon, i njohur si mesia nga ndjekësit e tij, shpërndau mbulesa fytyre për 30 000 persona,



por vetëm disa prej tyre i vendosën. Koreja e Jugut ka regjistruar 24 raste të shpërthimit të koronavirusit të ri që u shfaq në Kinën fqinje, ku janë konfirmuar më shumë se 30,000 raste dhe Seuli ka ndaluar hyrjen për të huajt që kanë qenë së fundmi në Wuhan, qendra e epidemisë.

FOTO E DITES



Një fotografi ajrore tregon pemë në një kopsht lulësh në Tajvan. /AFP/

E rrallë

Nëndetësja britanike përplas me mbetjet e Titanikut

Një nëndetëse e një kompanie britanike u përplas me mbetjet e Titanikut gjatë një ekspedite që ndodhi në mes të vitit të kaluar. Qeveria e Shteteve të Bashkuara e dinte për incidentin që nga fillimi dhe e mbajti të fshehur deri këtë vit. Kjo është përplasje e parë me anijen që është bërë publike pasi "eshtrat" e saj u zbuluan më



1985. Udhëheqësi i ekspeditës, Rob McCallum, pranoi në deklarata për shtypin se zhytja e gjenertës së ardhshme Triton u përplas me Titanikun në korrik kur "rryma intensive dhe shumë e paparashikueshme" bëri që piloti ta humbasë kontrollin. Megjithatë, ai vuri në dukje se dëmet ishin të vogla.

BARSOLETA E DITËS



E dashura: Qysh i fiton ti këto pare që po i harxhon?
Djali: Duke shkruar në telefon.
E dashura: Qysh kështu?
Djali: I shkruaj babës në Zvicër dhe i them se nuk kam para.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min


Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

| | | | | | |
|--|--|--|---|--|--|
|  <p>DASHI Për tërë ditën mund të mbështeteni në favoret e Hënës, të cilat do ta lehtësojnë jetën shoqërore.</p> |  <p>DEMI Padurimi është një e metë që duhet të përpiqeni ta kontrolloni, veçanërisht sot, nëse nuk doni të hidhni në erë një projekt të bukur.</p> |  <p>BINJAKËT Do të kënaqeni dhe vlerësoheni nga ata që janë afër jush edhe kur lëvizni kundër rrymës. Do të tregoni dashuri të thellë ndaj të dashurit tuaj.</p> |  <p>GAFORRJA Argëtohuni, mos humbisni asgjë! Nuk ka nevojë të shqetësoheni shumë për portofolin tuaj. Mërkuri, në pamje fantastike, vazhdon t'i mbrojtë financat tuaja.</p> |  <p>LUANI Shumë nga problemet që ju shqetësojnë do të zhduken nëse përballeni me një jetë pa stresse dhe mendime.</p> |  <p>VI RGJËR ESHA Mjafton të nxirni jashtë gjithë mirësinë që keni në zemrën tuaj. Jupiteri nuk ju braktis kurrë, madje në mes të stuhive të errëta, kjo është një pikë për avantazhin tuaj.</p> |
|  <p>PESHORJA Me përpjekjen minimale mund të arrish arritje personale me prestigj të madh. Në dashuri do të ndiheni të lumtur dhe të kënaqur.</p> |  <p>AKREPI Grindjet e vogla me partnerin janë të destinuara të zhduken shpejt pa lënë asnjë gjurmë. Prandaj është e ndaluar ta dramatizoni situatën: në momente të caktuara gjithçka duket e vështirë, por ato kalojnë shpejt!</p> |  <p>SHIGJETARI Lini makinën tuaj në garazh dhe përdorni këmbët tuaja për të ecur nëpër qytet. Do t'ju mbajë të përshtatshëm dhe do t'ju ndihmojë të relaksoheni.</p> |  <p>BRICJAPI Do të jeni të dashur dhe joshës, madje duke përfutur nga hijeshia që ju ushtroni ndaj të tjerëve, ju mund të merrni kënaqësinë personale. Do të keni shanse të shkëlqyera për korrur sukses në gjithçka!</p> |  <p>UJORI Këtë të hënë vendosni të bëni vetëm një gjë dhe përqendrohuni në atë. Nëse nuk mundeni, atëherë shkruajini takimet dhe oraret në agjendën tuaj që të jeni të përgjegjshëm.</p> |  <p>PESHQIT Me partnerin tuaj ju dini të jeni të ëmbël, të butë, të disponueshëm dhe bujar. Disa prej jush mund të kalojnë nëpër një fazë pagjumësie.</p> |

Sophia përgënjeshton mediat turke për ndarjen nga Karius



Mediat sportive dhe ato rozë në Turqi kishin raportuar ditët e fundit për një ndarje mes portierit të Besiktasit Loris Karius dhe modelueses së njohur Sophia Thomalla, por vetë kjo e fundit ka përgënjeshtuar menjëherë gjithçka. Nëpërmjet një reagimi në "Instagram", Sophia konfirmoi se vijon të jetë ende në lidhje me

Karius, madje më e lumtur se kurrë, ndërsa i quajti mediet si të rreme dhe me synim për ta shpërqendruar gardianin gjerman. Loris Karius është në pronësi të Liverpoolit, por pas gafave në finalen e Champions Leagues në 2018-n, u huazua për dy sezone te turqit e Besiktashit, ku e kanë ndjekur pas sërish gabimet e bujshme.

Gwen Stefani anulon koncertin për shkaqe shëndetësore



Aktorja e njohur Gwen Stefani ka thënë se e ka anuluar koncertin e saj në Las Vegas fundjavën që lamë pas për shkaqe shëndetësore. "Më falni, por unë nuk vazhdoj të ndihem mirë dhe nuk

jam e gatshme të performoj këtë të shtunë. Ajo ka thënë se është duke u munduar të bëhet mirë dhe planifikon të kthehet nga 12 shkurti", ka shkruar Stefani në llogarinë e vet në "Twitter".



U pagua mijëra euro, ç'do të bëjë Georgina Rodriguez me paratë e Sanremos

Shuma marramendëse që iu dha Georgina Rodriguezit sa i takon moderimit të saj në festivalin e Sanremos shkaktoi polemika. Disa komentues e konsideruan pagesë "të çmendur" shifrën prej 140.00 eurosh, para që gruaja e yllit Cristiano Ronaldo do t'i dhurojë për bamirësi. Bëhet fjalë për spitalin e fëmijëve "Regina Margherita" në Torino. Paratë do të shkojnë në ndihmë të

repartëve të spitalit të fëmijëve, ndërsa raportohet se do të përdoren për mirëmbajtjen dhe rinovimin e tij. Mediat italiane shkruajnë se stafi i modelueses argjentinase ka kontaktuar me spitalin për t'i komunikuar vendimin e Rodriguezit për t'i dhuruar paratë. Georgina Rodriguez u ngjiti në skenë mbrëmjen e së enjtes, e veshur me dy fustane nga stilistja shqiptare Lia Stublla.

Vanessa jep hollësi për shërbimin përkujtimor që do t'i bëhet Kobe Bryantit


Eveja e Kobe Bryantit ka bërë një njoftim lidhur me shërbimin përkujtimor publik që do t'i bëhet legjendës së Lakersit. Varrimi do të mbahet më 24 shkurt në Staples Center në Los Angeles derisa paralajmërohet se më shumë detaje do të bëhen publike më vonë. Varrimi është planifikuar të mbahet afërsisht një muaj pas vdekjes së Kobe dhe vajzës së tij 13-vjeçare Gianna. Në këtë



ngjarje tragjike vdiqën edhe shtatë të tjerë në Calabasas të Kalifornisë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Ballkani, Drenica dhe Prishtina sigurojnë gjysmëfinalen

Janë zhvilluar tri ndeshjet e çerekfinale të Kupës, kurse kualifikimin e siguruan Ballkani, Drenica dhe Prishtina, pasi arritën të shënojnë fitore ndaj Dukagjinit, Gjilanit dhe Vushtrrisë. Ndeshja e fundit çerekfinale zhvillohet të mërkurën në mes të Lirisë dhe Feronikelit



Hasan Hyseni, derisa golin e nderit për mysafirët e realizoi Fiton Hajdari. Ndërsa në ndeshjen tjetër të zhvilluar në "Fadil Vokrri", Prishtina ishte dukshëm skuadër më e mirë se Vushtrria, duke shënuar fitore me rezultat 4-1. Endrit Krasniqi me golin e shënuar nga penalltia dhe Oto John shënuan në pjesën e parë për vendasit, kurse mysafirët shënuan në fund të kësaj pjese me Drilon Fazliun për 2-1. Në pjesën e dytë John dhe Ahmeti realizuan dy golat e tjerë për kryeqytetasit që synim e kanë triumfin në Kupë. Gjysmëfinalisti i fundit vendoset të mërkurën, ku përballen Liria dhe Feronikeli.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 SHKURT - Kampioni i vjeshtës, Ballkani, është kualifikuar në gjysmëfinale të Digitalb Kupës së Kosovës në futboll, pasi në çerekfinale e mposhti të dielën skuadrën e Dukagjinit (0-2). Pjesa e parë e ndeshjes e zhvilluar në Klinë përfundoi 0-0, por dy minuta pasi filloi pjesa e dytë mysafirët nga Suhareka kaluan në epërsi me golin e Blend Baftiut, kurse njëmbëdhjetë minuta më vonë Ballkani realizoi edhe golin e dytë nëpërmjet sulmuesit nga Shqipëria,

Artur Magani. Në këtë mënyrë skuadra e Ismet Munishit vazhdon rrugëtimin drejt triumfit në garën e Kupës, kurse Dukagjini do ta vazhdojë ëndrrën për ta siguruar mbijetesën në IPKO Superligë. "Dukagjini luajti mirë në pjesën e parë, madje rezistoi mjaft shumë duke krijuar edhe raste, por pjesa e dytë nisi mjaft mirë për ne me një gol të hershëm dhe çdo gjë më pas ishte më e lehtë. Në gjysmëfinale kemi mbetur mjaft skuadra të forta. Unë e llogaris Drenicën si rivale shumë të fortë. Gjithsesi presim shortin pas ndeshjes së fundit të Feronikelit dhe Lirisë. Ballkani

tashmë do të jetë i koncentruar në ndeshje të kampionatit ku na presin sfida të vështira. Unë mendoj se prej të gjitha ekipeve Ballkani më së miri do ta përfaqësojë Kosovën në Evropë dhe do të ishte mëkat nëse nuk do të luajmë këtë vit", ka thënë Ismet Munishi, trajner i Ballkanit.

Në gjysmëfinale janë kualifikuar edhe Drenica dhe Prishtina. Skuadra kuqezi nga Skenderaj tejkaloi parashikimet dhe e mposhti me rezultat 2-1 skuadrën e Gjilanit, e cila shihej si favorite. Koha e rregull përfundoi 0-0, kurse në vazhdimë u shënuan tri golat. Për Drenicën realizuan Genc Hamiti dhe

REZULTATET

| | |
|-----------------------|-----|
| Dukagjini - Ballkani | 0-2 |
| Drenica - Gjilani | 2-1 |
| Prishtina - Vushtrria | 4-1 |

Të mërkurën takohen:
12:30 Liria - Feronikeli

Distria, e artë në Paris; Nora, e bronzte

PRISHTINË, 9 SHKURT - Xhudistja Distria Krasniqi ka shkëlqyer në Grand Slamin e zhvilluar në Paris pasi e fitoi medaljen e artë. Krasniqi në finale e mposhti italianen Odette Giuffrida në kategorinë 52 kilogramë. Në luftën e parë Krasniqi e mposhti algerianen Faiza Aissahnine, kurse në të dytën triumfoi ndaj francezes Bonna Penelope. Xhudistja pejane në gjysmëfinale u kualifikua pas triumfit kundër japonezes Ai Shishime, ndërsa më pas e mposhti Sarah Menezes nga Brazili në minutat shtesë të ndeshjes dhe u kualifikua në finale, ku doli më e suksesshme se Giuffrida. Ndërsa medaljen e bronzte e ka fituar Nora Gjakova, në kategorinë 57 kilogramë, pasi shënoi fitore me ippon ndaj francezes Sarah Leonie Cysique. Trajneri Driton Kuka është shprehur i lumtur me suksesin e nxënëseve të tij. Pas triumfit të Krasniqit, Kuka ka shkruar në "Facebook": "Po, po, Parisi prapë merr frymë shqip. Distria e artë para 20 mijë



shikuesve në Paris Bercy. Grand Slami i Parisit për të gjashtën herë po flet shqip me medalje të arta. Kosova mbi të gjitha". Kjo ishte hera e parë që Nora Gjakova arriti të marrë medalje në Paris. "Nora e bronzte. Medalja e saj e parë në Paris. Sa krenar që jam me nxënëset e mia, aty në zemër të Francës. Kosova mbi të gjitha", ka shtuar Kuka.

Karateistët rrëmbejnë katër medalje në evropianin për të rinj

PRISHTINË, 9 SHKURT - Pas medaljes së bronzte të arritur të shtunën nga karateisti Betim Maliqi, Përfaqësuesja e Kosovës të dielën ka arritur t'i rrëmbejë tri medalje të tjera në Kampionatin Evropian për të rinj që po mbahet në Budapest të Hungarisë. Federata e Karatesë së Kosovës ka bërë me dije se medalje të bronzte kanë arritur Benjamin Shabani, Vesa Ibrahimimi dhe Albulena Gërvalla. Shabani, që luftoi në kategorinë U21 me mbi 84 kilogramë, fitoi medaljen e bronzte duke mposhtur garuesit nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Greqia, kurse pësoi nga garuesi nga Ukraina. Për medalje të bronzte, në repesazhë, ai e mposhti garuesin nga Turqia me rezultat prej 5 me 0. Edhe Vesa Ibrahimimi garoi në kategorinë U21, deri në 68 kilogramë. Ajo fitoi ndaj garueseve nga Maqedonia



Veriore, Finlanda e Bjellorusia. Derisa humbi nga garuesja nga Rusia. Në garë për të bronzten shkëlqeu duke fituar me rezultat prej 8 me 1 ndaj garueses nga Franca. Kurse me katër fitore e një humbje medalje të bronzte mori edhe Albulena Gërvalla në kategorinë U21, deri në 55 kilogramë.

Gjyqtarët e Kosovës ndihmojnë portierin Arben Beqiri

Mitrovicë, 9 shkurt - Kryetari i gjyqtarëve të Kosovës në kuadër të Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Përparim Hasani, e ka vizituar portierin e Trepçës '89, Arben Beqiri, i cili është diagnostifikuar me tumor.

Hasani ia dorëzoi Beqirit 775 euro të cilat i grumbulluan gjyqtarët e Kosovës. "Se bashku me bashkëpunëtorë vizituam portierin e KF Trepça'89, Arben Beqiri. Ky i fundit muaj më parë bëri të ditur për opinion se është

diagnostifikuar me tumor në lukth. Në emër të gjyqtarëve gjatë kësaj vizite i dhamë kurajë Arbenit dhe e inkurajam duke shpresuar që sa më shpejt të kthehet në fushat e blerta. Po ashtu, në emër të gjyqtarëve iu

dorëzua shuma prej 775 eurosh, të cilën e kanë mbledhur gjyqtarët me vetiniciativë", ka thënë Hasani. Portieri Beqiri i falënderoi gjyqtarët për mbështetjen morale dhe financiare.



Peja fiton derbin me Bashkimin, Lipjani shijon fitoren e dytë

PEJË, 9 SHKURT - Peja ka mundur Bashkimin me rezultat 103:80 (31:20, 18:16, 33:28, 21:16) në sfidën e fundit për javën e 25-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Vendasit e nisën ndeshjen mirë, duke e fituar çerekun e parë me rezultat 31:20. Lojë më e barabartë

ishte në periudhën e dytë që përfundoi 18:16. "Verdhezinjtë" ishin më të mirë edhe në pjesën e dytë, duke e fituar periodën e tretë 33:28 dhe atë të fundit 21:16, për të triumfuar në fund me rezultat 103:80. Te Peja më të dalluarit ishin Dardan Berisha me 25 pikë,

katër kërcime dhe asistime, Richard Jacksoni me 19 pikë e 12 kërcime dhe Drilon Hajrizi me 14 pikë, 10 kërcime e pesë asistime, derisa te Bashkimi, Terik Bridgeman, realizoi 18 pikë e pesë kërcime. Të dy skuadrat tani kanë nga 13 fitore dhe nëntë humbje. Ndërsa

Lipjani ka shënuar fitore ndaj Feronikelit si mysafir me rezultat 62:68 (23:12, 13:22, 13:20, 13:14). Dayon Griffin u dallua te Feronikeli me 25 pikë, pesë kërcime e katër asistime, derisa te Lipjani edhe kësaj radhe u dallua Tamas Bruce me 23 pikë e 14 kërcime.



Azemi: Trepça e gatshme për befasi në 'Final 8'

MITROVICË, 9 SHKURT - "Oso Termosistem Final 8" po pritet me interesim të jashtëzakonshëm. Tetë skuadra në garë për trofeun e çmuar të Kupës. Ndeshjet pritet të jenë shumë interesante, pasi skuadrat kanë cilësi të përafërta. Skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës, Trepça, shpreson të ketë suksese në garat e Kupës. Basketbollisti me përvojë i mitrovicasve, Besnik Azemi, flet për synimet e 'Xehetarëve' në këtë garë. "Final 8' ka shumë rëndësi për Trepçën. Në ndeshjen kundër Rahovecit udhëtojmë për ta dhënë maksimumin që e kemi si ekip. E kemi parasysh që Rahoveci është vendas dhe ka motiv shtesë, mirëpo ne shkojmë për fitore. Ndeshjet janë eliminuese dhe secili ekip ka gjasa të vazhdojë tutje, sidomos në këtë vit, ku liga është shumë e niveluar", ka deklaruar Azemi për faqen zyrtare të FBK-së. Ndeshjet e "Final 8" do të mbahen nga 11 deri më 15 shkurt në qytetin e




Rahovecit. Kjo është hera e dytë radhazi që Final 8 mbahet në qytetin e

Rahovecit dhe pritet të jetë spektakolar si në fushë, ashtu edhe në tribuna.

Lakersat iu rikthehen fitoreve

LOS ANXHELOS, 9 SHKURT - Los Angeles Lakers rikthehet te fitorja në sfidën ndaj Golden State Warriorsit. Një sukses i ngushtë i skuadrës kaliforniane me shifrat 125-120 në "Chase Center" në San Francisco. Anthony Davis ishte basketbollisti më i mirë me 27 pikë, 10 rebounde dhe 4 asistime, paraqitje kjo që ndihmoi Lakersin ta koleksionojë suksesin e 39-të sezonal, ndërkohë që Warriorsi pësoi disfatën numër 41-të. Skuadra e momentit në NBA është pa diskutim Toronto Raptors. Kampionët në fuqi koleksionuan suksesin e 14-të rresht pasi mposhtën me rezultat minimal 119-118 Brooklyn Netsin. VanVleet me 29 pikë ishte basketbollisti më i mirë mbi parket për Warriorsin, ndërkohë që dallimin në këtë sfidë e bëri loja në grup e skuadrës kanadeze pasi plot pesë basketbollistë të Raptorsit kapën një kuotë pikësh me dy shifrat duke



bërë të pavlefshme edhe paraqitjen spektakolare të LeVert për Brooklyn, autor i 37 pikëve. Me 31 pikë të Hieldit dhe 25 të Barnesit, Sacramento Kingsi mposhti lehtësisht San Antonio Spursin me rezultat 122-102. Pavarësisht mungesës

së Luka Doniqit, Dallas Mavericksi regjistroi një fitore të lehtë, pasi mposhti me rezultat 116-100 Charlotte Hornetsin në parketin e këtyre të fundit. Më i miri mbi parket për Dallasin në këtë sfidë ishte Curry me 26 pikë.

Kaka: Firmino dhe Suarez janë sulmuesit më të mirë në botë, Alisson portieri më i mirë

Legjenda e futbollit brazilian, Kaka, ka folur në lidhje me suksesin e Liverpoolit dhe për lojtarët brazilianë që janë në skuadrën kryesuese të kampionatit anglez. Ai e shijon performancën e tyre dhe beson se do të jenë po aq të suksesshëm dhe me kombëtaren e Brazilit. "Liverpooli po bën një

sezon fantastik. Më pëlqen shumë, pasi janë në formë dhe luajnë mjaft mirë. Një futboll i bukur për t'u parë me ndryshime të shumta pozicionesh dhe skemash. Kloppi nga krahu tjetër është shumë trajner i mirë, ai nuk ka frikë nga zëvendësimet dhe deri tani i kanë dalë mirë. "Brazilianët e

Liverpoolit kanë bërë mjaft mirë deri më tani. Jam krenar që Alissoni, Fabinho dhe Firmino po paraqiten kaq mirë. Alissoni është portieri më i mirë në botë, Fabinho ndër mesfushorët më të mirë dhe Firmino sulmuesi më i mirë. Mendoj se ai me Suarezin janë më të mirët mentalisht".

SHKURT

Ramadani, kampion i Ballkanit në hedhjen e gjyles

Muhamet Ramadani ka treguar forcën e tij edhe në kampionatin ballkanik U-20 të atletikës në sallë që po mbahet në Stamboll të Turqisë. Medalisti i artë i EYOF Baku 2019 fitoi medaljen e artë në hedhjen e gjyles 6 kg. Ramadani e hodhi gjylen në largësi 19.20 metra, kurse garuesi tjetër Alaudin Suma ka arritur që ta hedhë gjylen vetëm 15.89 metra duke marrë vendin e shtatë.

Gjyqtarët 'i rrëmbejnë' fitoren Ilir Latifit

Ilir Latifi është mposhtur nga Derrick Lewis në kuadër të UFC 247. Ish-sfiduesi për titullin e kampionit në pesha të rënda mposhti me vendim unanimit të gjyqtarëve. Gjyqtarët vendosën 29-28 në favor të Lewisit. Ilir Latifi bëri ndeshje të mirë por që, sipas gjyqtarëve, nuk mjaftoi.

Skautët të katër klubeve në ndjekje të Kumbullës


Marash Kumbulla ishte lojtari më i mirë në ndeshjen ku Hellas Verona mposhti Juventusin (2-1). Mbrojtësi shqiptar tregoi një paraqitje të shkëlqyer, duke ndalur Ronaldon, por edhe sulmuesit e tjerë të Juventusit. Gjithashtu, 20-vjeçari shënoi edhe një gol, por iu anuluan për pozicion jashtë loje. "Tuttosport" raporton se nga afër e kanë ndjekur skautët të 4 klubeve të mëdha mbrojtësin kuqezi. Bëhet fjalë për Manchester Cityn, Manchester Unitedin, Borussia Dortmundin dhe Aintracht Frankfurtin.

Liverpooli, favorit në garë për Wernerin

Anëtar i Leipzigit, Timo Werner, ka shkëlqyer në Bundesliga, duke mos pasur telashe ta gjejë rrugën e golit, duke tërhequr kështu vëmendje nga shumë skuadra të mëdha evropiane. 'The Athletic' bën të ditur se Liverpooli është skuadra favorite për të nënshkruar me sulmuesin gjerman. Jurgen Klopp është i vendosur që të shtojë një sulmues në skuadër dhe 23-vjeçari është lojtari që prin në listën e dëshirave. Werner, i cili është edhe në radarin e Chelseas e Bayern Munichit, ka shënuar 20 gola në 20 ndeshje të Bundesligas këtë sezon.

Messi nuk e ka ndërmend të largohet nga Barça

Ylli argjentinas Lionel Messi nuk e ka ndërmend të largohet nga Barcelona edhe përkundër problemeve të fundit. Klubi katalunas ka duruar një javë mes turbullirave, pasi drejtori sportiv, Eric Abidal, kritikoi publikisht lojtarët e ekipit. Kapiteni Leo Messi vendosi t'i reagojë Abidalit duke marrë në mbrojtje veten dhe bashkëlojtarët e tij. Sipas mediumit britanik "Express.co.uk", Manchester City i është thënë se Messi nuk e ka në plan të largohet nga Barcelona këtë verë dhe se ideja e tij është të pensionohet në "Camp Nou".

| | | | | | | | | | | | | | | |
|--|---|---|----------------------|--|---|---|--------------------|---|----------------------------|---|--|----------------------------------|-----------------------------|---|
|  | Autor: GAZMEND MORINA | | | | DËSHMORI NË FOTO 1 (KOMANDANT SHEMI) | LLOJ MINE-RALI QË PËR-DORET PËR PLLAKA IZOLIMI (shq.) | KËNGËTARJA KËRÇELI | SHTET (Fr.) FLORI | BABAIT | VEÇORI THELBËSORE E NJË SENDI (sh.shq.) |  | | | |
| | ZHURMË E MADHE NGA TË THIRRURAT E DY A MË SHUMË VET-AVE (sh.shq.) | | | | | | | | | | | | | |
| | PRINCIPATË ARABE (shq.) | | | | | | | | | | | | | |
| | VALMIR (perkdh.) | | | | | | | LLOJ, SOJ QË ËSHTË KTHYER NË GJENDJE TË LËNGËT; I SHKRIRË | | | | | | |
| | VËLLIM, MASË | | | | | | | | TONI ADAMS DY ZANORE | | | | | |
| | ZEMËRIMI, EGËRSIMI | | | | | | | | | BASHKËTING. BESNIKU (perkdh.) | | | | |
| KALË SHALE | | | | | | | | | | AKTORJA AMERIKANE ZELLUEGER LËRE (bised.) | | | | |
| EPOKA E RE | KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE | GRUA A VAJZË QË VALLËZON ME NJË KAVALIER (shq.) | E PASUR, PASANIKE | RRALLË (Lat.) | DREDHI QË BËHET PËR TË MASHTRUAR DIKË ZANORE | | | | ISMET TOTO QESËNDI, TALLJE | DËSHMORI NË FOTO 2 (HISTORIANI) | "E" para dy "A" | VEGËL MUZIKORE; KITARË (bised.) | ZANORE | LLOTO-SPORT |
| ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË | | | | | | | | | | | | | | |
| FJALË QË THUHEN PËR TË QESHUR E PËR T'U ZBAVITUR | | | | | ERMELINDA MEKSI KËNGËTARJA SHQIPTARO-AMERIKANE KRISTINË | | | SHTET NË AMERIKËN JUGORE (Kryeqytet MONTEVIDEO) | | | | | | SIENA AKTORJA ARVANITASE PAPAS |
| BISKOTË E GATUAR ME ARRA (shq.) | | | | | | | | "ROMA" INDIUM | | | PIKTORI VALLA (shq.) VEPËR E KRYER, PUNË | | | EMËR FEMRE MYSLIMANE |
| ZULMË | | | | MUNGESA E SHTYPJES, E VARËSISË DHE E KUFIZIMEVE DESPOTIK | | | | VEPRIMTARI HASANI NDËRRIM I MALLIT | | | | | LLOJ PAPA-GALLI BASHKËTING. | |
| BASHKËTING. | | VEGËL MUZIKORE SHKRIMTARI DEMAKU | | | | | | | | | | | | REGJISORI KRYEZIU ENË E MADHE PREJ TENË-QEJE PËR QUMËSH |
| FUTBOLLISTI BESIAN | | | | | | | | BASHKËTING. OBJEKTI I BISEDËS | | | "T" para dy "M" HENRIK (perkdh.) | | | KËNGËTARJA ... KOÇI URAN, TITAN |
| EPOKA E RE | ZANORE KËNGA QË I KËNDOHET TË DASHURËS ME KITARË NËN DRITARE | | | BAKËRPUNUES KËNGËTARJA BUNJAKU | | | | | | | | | | ABEDIN REXHA QË ËSHTË ME TINGUJ TË ÇRRREGULLUAR |
| AKTORI DHE REGJISORI RAÇA | | | | | PESHA E MALLIT PA AMBALAZH | EMINE (perkdh.) ZANORE | | | | | PJESË E ARMËS SË ZJARRIT RESTAURANT INSPECTION INFORMATION | | | ZANORE SHKRETËTIRA MË E THATË NË BOTË |
| GAZ I PANGJYRË DHE PA ERË | | | | | MINDER I ULËT KËNGËTARJA ÇELO | | | | | | PREVA DEGËT E NJË PEME SËPATË E VOGËL (sh.shq.) | | | MOR, HEJ (psth.) |
| BASHKËTING. | | KAMBANË E VOGËL ISH SHEFI I CIA-së XHORXH | | | | | | AKTORI HOL-LIVUDIAN .. PAÇINO MA JEP | | | IRNOSE (bised.) RENIUM, METËR | | | TRAJNERI GJERMAN REHAGEL |
| PUSULLA | | | | | | | | PORTIERI BEQAJ AKTORJA E NJOHUR JESSICA | | | | | | SHEGË SHTEG |
| NEON, FLUOR | | | | | BIMË QË PËR-DORET GJERËSISHT SI USHQIM PYLL | | | | | | SHKRONJË GREKE | SHTET NË AZI NUMËR THEMELOR (F.) | | MUNDIM; VËSHTRËSI |
| PAGJAKËSI | | | | | FJALË E RËNDË DHE E PAHJUSHME KYÇ | | | | | | | | | DËSHMORI KODRA ISMET MUNISHI |
| "DETROIT" | | | SKAJI, QOSHJA ZANORE | | | | | BOLOGNA, TREVISO SHKRONJA XXVIII | | | GUXIMTAR BASHKËTING. | | | "MOLDE" BASHKËTING. |
| KLUB FUTBOLLI ITALIAN | | | | | | | | | MUZIKANTI KRASNIQI | | | | | ILAÇ |

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: E. SHAMATAT, EMIRATI, MIR, TIP, SASI, TA, INATI, R, AT, RENE, HILE, IT, ADERIM, ETIK, RREGULL, SHAKA, EM, URUGUAI, S, AMARETA, RO, ESATI, NAM, LIRI, NAIT, ARA, T, UTE, ANTIK, EKREM, IDRIZAJ, R, TMM, ENI, A, RAMATAR, AHU, AR, SUNAJ, EMI, TYTA, E, ETAN, NIM, KRASITA, R, ZILE, AL, RE, OT, ETIKETA, ARIAN, NAR, NEF, DOMATE, IRAK, ANEMI, ALAMET, ILAZ, DE, ANA, BT, TRIM, MO, ATALANTA, NAIM, BAR.

20 vjet pa ty bab, heroi ynë

Zahir Mehmeti

(08.04.1960-10.02.2000)

Humbja yte sot e njëzet vjet na drithëron trupin, na ndan një pjesë të zemrës, na këput një pjesë të rritës sonë, duke mos dashur asnjëherë ta pranojmë e ta besojmë ikjen tënde të hershme në përjetësi, babai ynë i dashur.

Ashtu sikur ky vit i brishtë, e brishtë është gjithë jeta jonë pa ty; pa frymëmarrjen tënde, pa fjalët tua të çmuara, pa misionin tënd si mësues i përkushtuar për nxënësit e tu, që aq shumë i ke dashur.


Ne u rritëm me mungesën tënde; me zbrazëtinë shpirtërore për ty, me humbjen e thirrjes "bab", me ikjen e qenies sate, duke na mbetur veç grimca kujtimesh, bashkë me ty. Shpeshherë na shfaqesh si hije në ëndrrat tona, na kumbon jehona e zërit tënd të qetë, si dhe dëgjojmë e shkruajmë rrëfimet e të tjerëve për ty. Ne vazhdojmë t'u besojmë tregimeve të nanës sonë tashmë të ndjerë, bashkudhëtares tënde, se ti na shikon çdo ditë nga qielli dhe do të takohemi përsëri një ditë...

Mallkojmë sëmundjen që ta shkurtoi ty jetën në moshën më të mirë, e ne mbetëm jetime.

Shpirti yt i bardhë pastë dritë e pushoftë në parajsë, bab- heroi ynë i pavdekshëm!

Përgjithmonë në zemrat e mendjet e tri vajzave tua:

Liridona, Lindita, Antigona.



C.nr.610/2018


GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me zyratën ligjore Albana Curri, në çështjen kontestuese të paditëses Fllaze Feraj (e lindur Hoti), nga Gjakova, Rr. "Mit'hat Frashëri" nr. 132, të cilën e përfaqëson i autorizuari Prek Kola, avokat në Gjakovë, kundër të paditurit Ramiz (Shaban) Feraj, më parë nga fshati Goden, Komuna e Gjakovës, tani në adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Avdi Rizvanolli, avokat në Gjakovë, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, jashtë shqyrtimit, me datë 29.01.2020, mori këtë:

AKTVENDIM

Të paditurit Ramiz (Shaban) Feraj, më parë nga fshati Goden, Komuna e Gjakovës, tani në adresë të panjohur, i **CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm Avdi Rizvanolli, avokat në Gjakovë, i cili ka për obligim që të paditurin në fjalë të e përfaqësojë në procedurën civile në lëndën C.nr.610/2018, sipas padisë të paditëses Fllaze Feraj (e lindur Hoti), nga Gjakova, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe atë gjerë në momentin kur i padituri i lartpërmendur, personalisht apo eventualisht ndonjë i autorizuar i tij, nuk lajmërohet në Gjykatë, ashtu që përfaqësuesi i përkohshëm mund t'i ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për të paditurin në fjalë, të paraparë në bazë të Ligjit.

Andaj, luteni që përmbajtjen e këtij Aktvendimi siç është cekur më lartë ta publikoni në Gazetën zyrtare të Kosovës (ose në mungesë eventuale të saj), në ndonjërin nga të përditshmet ditore dhe lidhur me këtë të e njoftoni Gjykatën. Ky Aktvendim njëherit të publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.610/2018 datë 29.01.2020



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj kujdestare
për vajzën 7 muajshe
në Prishtinë.
Për informata në
tel: 044-444-009**

► Kapllan Sinani shpall të pavlefshme dëftesat e SHF "Millun Jakshiq" (kl.I-VIII) Runik.

► Kastriot Sadiku shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik "Isa Boletini" Mitrovicë.

► Petrit Selimi shpall të pavlefshme diplomën e SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalitë me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

| | |
|-------------------------------------|--|
| Emri i Institucionit | <i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i> |
| Titulli i punës: | Zyrtar për statistika në zyrat rajonale në Gjilan, Prizren , Gjakovë dhe Pejë |
| Numri i referencës: | ASK-DRA-001 |
| Tarifa e shërbimit: | 437.55 bruto |
| Raporton te: | Udhëheqësi i zyrës rajonale |
| Lloji i kontratës: | Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV) |
| Kohëzgjatja e kontratës: | Gjashtë (6) muaj |
| Orari i punës: | I plotë |
| Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve: | ASK -4 |

-Detyrat dhe përgjegjësitë: Zyrtar për statistika në zyrën rajonale në Gjilan

-Kryen anketat për të gjitha hulumtimet statistikore në nivel të rajonit të Gjilanit, grumbullimin, monitorimin dhe kontrollimin e çmimeve të konsumit të gjerë si dhe plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e raporteve tremujore të çmimeve të Importit- ICI,
- Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raporteve tremujore të çmimeve të prodhimit industrial- PPI , plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e raporteve mujore të hotelierisë dhe turizmit, plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin anketës së mbeturinave komunale dhe anketës së mbeturinave të trajtuara.
-Shpërndan,plotëson,kontrollon dhe sistemon raportet mbi statistikat e arsimit(shkollave) si dhe bënë kontrollimin dhe analizën logjike të hulumtimeve statistikore,
-Kryen grumbullimin, monitorimin dhe kontrollimin e çmimeve të artikujve bujqësor, plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Raportet tre mujore të statistikave afatshkurtra të industrisë STS, plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të ndërtimitarisë STS, si dhe raportet të statistikave vitale si dhe kryen grumbullimin, monitorimin dhe kontrollimin e çmimeve të konsumit të gjerë
-Zhvillon Anketën mbi buxhetin e ekonomive shtëpiake, në ekonomitë familjare ,intervista,shpërndarjen ditareve , plotësimin anketave, udhëzon për plotësimin e ditareve të shpenzimeve, vizitat javore në ekonomitë familjare , përfshirjen dhe kontrollimin i informatave të mbledhura në anketën mbi buxhetin e ekonomive shtëpiake si dhe zhvillon raporte të mira me responentët.
-Raporton te Shefi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar Departamenti i ASK.

Kualifikimi : Diploma Universitare – Fakulteti nga fushat Ekonomike , Shoqërore dhe Juridike.

Përvoja e punës e preferuar në fushën relevante

Shkathësitë , aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel ,Outlook) ,
-Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale- e nevojshme
- Entuziast ,energjik ,diplomatik ,diskret-e nevojshme
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës- nevojshme

-Detyrat dhe përgjegjësitë: Zyrtar për statistika në zyrën rajonale në Prizren

-Shpërndan anketat për të gjitha hulumtimet në nivel të rajonit të Prizrenit.
- Kujdeset për shpërndarjen distribuimin dhe grumbullimin e raporteve të statistikave vitale dhe pjesërisht ABESH në teren, kontakton me responentet,si dhe udhëzon plotësimin e formularëve të anketave statistikore,
-Bënë analizën logjike të hulumtimeve statistikore,
-Kujdeset për shpërndarjen distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren ,
-Me kërkesën e udhëheqësit të Zyrës rajonale, përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në teren gjatë procesit të implementimit të projektit si dhe zhvillon raporte të mira me responentët,
-Raporton te udhëheqësi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar Departamenti i ASK.

Kualifikimi : Diploma Universitare – Fakulteti nga fushat Ekonomike , Shoqërore dhe Juridike.

Përvoja e punës e preferuar në fushën relevante

Shkathësitë , aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel ,Outlook) ,
-Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale- e nevojshme

- Entuziast ,energjik ,diplomatik ,diskret-e nevojshme
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës- nevojshme

Detyrat dhe përgjegjësitë: Zyrtar për statistika në zyrën rajonale në Gjakovë

-Kryen anketat për të gjitha hulumtimet statistikore në nivel të Rajonit të Gjakovës.
-Kujdeset për shpërndarjen, distribuimin materialit në teren, grumbullimin materialit nga njësit raportuese, kontrollimin dhe sistemin e raporteve të statistikave vitale.
-Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të industrisë
- Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e raporteve tremujore të statistikave afatshkurtra të ndërtimitarisë
-Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Qmimeve të IQPV.
- Kryen plotësimin, monitorimin dhe kontrollimin e Qmimeve të Importit.
Shpërndan,plotëson dhe kontrollon Anketen e bugjetit familjarë.
-Kryen plotëson, dhe monitoron Raportet për Kulturë dhe Sportë.
-Zhvillon raporte të mira me responentët si udhëzon plotësimin e formularëve të anketave statistikore
-Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të hulumtimeve statistikore si dhe kujdeset për shpërndarjen, distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren ,
-Me kërkesën e shefit të Zyrës rajonale, përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në teren gjatë procesit të implementimit të projekteve të planifikuara nga ASK-ja .
-Raporton te Shefi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar Departamenti i ASK

Kualifikimi : Diploma Universitare – Fakulteti nga fushat Ekonomike , Shoqërore dhe Juridike.

Përvoja e punës e preferuar në fushën relevante

Shkathësitë , aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel ,Outlook) ,
-Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore,
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale- e nevojshme ,
- Entuziast ,energjik ,diplomatik ,diskret-e nevojshme,
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës- nevojshme.

-Detyrat dhe përgjegjësitë: Zyrtar për statistika në zyrën rajonale në Pejë

-Kryen anketat për të gjitha hulumtimet statistikore në nivel të Rajonit të Pejës,
-Raporte mujore të demografisë,
-Raporte të çmimeve të indeksit të ndërtimitarisë , industrisë , import -eksport ,
-Raporte mujore të çmimeve të bujqësisë, anketa të TTK,
-Bënë kontrollimin dhe analizën logjike të hulumtimeve statistikore si dhe kujdeset për shpërndarjen, distribuimin dhe grumbullimin e raporteve në teren ,
-Raporte të statistikave vjetore të ujërave dhe peshkatarisë ,mbeturinave komunale.
-Me kërkesën e shefit të Zyrës rajonale, përcjell dhe monitoron personat e angazhuar në teren gjatë procesit të implementimit të projekteve të planifikuara nga ASK-ja .
-Raporton te Shefi i zyrës rajonale për dinamiken e aktiviteteve sipas agjendës që ka parashtruar Departamenti i ASK

Kualifikimi : Diploma Universitare – Fakulteti nga fushat Ekonomike , Shoqërore dhe Juridike.

Përvoja e punës e preferuar në fushën relevante

Shkathësitë , aftësitë:

-Njohja e kompjuterit (Word ,Excel ,Outlook) ,
-Bashkëpunimi në mënyrë ekipore e nevojshme,
-Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore,
- Shkathësi në realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor të zyrës rajonale- e nevojshme ,
- Entuziast ,energjik ,diplomatik ,diskret-e nevojshme,
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave të punës- nevojshme.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/> Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, Diploma e fakultetit, si dhe dokumentet tjera të përcaktuara në konkurs(të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranura, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikacionet të cilat dërgohen nëpërmjet postës do të konsiderohen të vlefshme të gjitha ato aplikime të cilat e mbajnë datën në dërgesën e dërguar deri në ditën e fundit të afatit të dorëzimit dhe do të konsiderohen nëse arrijnë brenda 3 ditëve, aplikacionet e pranura pas këtij afati dhe aplikacionet jo të plota nuk do të pranohen.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 141 prej orës 08:00 – 16:00.

¹ Përshih: Nr. Telefonit si dhe një adrese elektronike



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosova, Administrativnog Uputstva br.08 / 2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br. 04 / Z-077 o Obligacionim Odnosima, Agencija za Statistiku Kosova, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

| | |
|-----------------------------|--|
| Naziv institucije: | Agencija za Statistiku Kosova |
| Naziv radnog mesta: | Službenik za Statistiku u Regionalnim Kancelarijama u Gnjilanu, Prizrenu, Đakovici i Peći |
| Referentni broj: | ASK-OPA-001 |
| Tarifa usluga: | 437.55 bruto |
| Izveštava: | Šefu regionalne kancelarije |
| Vrsta ugovora: | Sporazum za Posebne Usluge-(SPU) |
| Trajanje ugovora: | Šest (6) meseci |
| Radno vreme: | Puno |
| Lokacija i broj izvršilaca: | ASK -4 |

- Zadaci i odgovornosti: Službenik za Statistiku u Regionalnoj Kancelariji u Gnjilanu

-Obavlja ankete za sva statistička istraživanja na nivou regiona Gjilana, prikuplja, prati i vrši kontrolu cena široke potrošnje kao i popunjavanje, prati i vrši kontrolu kvartalnih izveštaja o Uvoznim Cenama-IUC;

- Popunjavanje, prati i vrši kontrolu kvartalnih Izveštaja o Cenama industrijske proizvodnje-CIP; Popunjavanje, prati i vrši kontrolu mesečnih Izveštaja o Ugošteljstvu i Turizmu; popunjavanje, prati i vrši kontrolu ankete o komunalnom otpadu i ankete o obrađenom otpadu;

- Raspodeli, popunjavanje i kontroliše i sistematizuje izveštaje o statistikama obrazovanja (škola) kao i vrši kontrolu i logičku analizu statističkih istraživanja;

- Prikuplja, prati i kontroliše cene poljoprivrednih proizvoda; popunjavanje, prati i kontroliše kvartalne izveštaje kratkoročnih statistika Industrije-KSI; popunjavanje, prati i kontroliše kvartalne izveštaje kratkoročnih statistika Izgradnje-ITI, kao i izveštaje o vitalnim statistikama; prikuplja, prati i kontroliše cene široke potrošnje;

- Obavlja Anketu o budžetu domaćinstava, u domaćinstvima, intervjuje, raspodeljuje dnevnike, popunjavanje ankete daje uputstva o popunjavanju dnevnika o troškovima, vrši nedeljne posete domaćinstva, obuhvat i kontrolu podataka prikupljenih u Anketi o budžetu domaćinstava, kao i razvija dobre odnose sa ispitanicima;

-Izveštava šefu Regionalne Kancelarije o dinamici aktivnosti prema dnevnom redu koji je dostavljen od Odeljenja ASK-a.

Kvalifikacija: Univerzitetska diploma- Ekonomski fakultet, fakultet iz oblasti društvenih nauka ili pravni fakultet.

Radno iskustvo: poželjno u relevantnoj oblasti

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje rada na računaru (word, excel, Outlook);
- Saradnja u timski rad, potrebni;
- Sposobnost da sačuva poverljivost pojedinačnih statističkih podataka;
- Veštine u izvršavanju radova i zadataka prema godišnjem planu regionalne kancelarije – su potrebne;
- Entuzijasta, energičan, diplomata, diskretan-potrebno;
- Ažuran i spreman za obavljanje radnih zadataka-potrebno.

Zadaci i odgovornosti: Službenik za Statistiku u Regionalnoj Kancelariji u Prizrenu

- Distribuirati ankete za sva istraživanja na nivou regiona Prizrena;

- Vodi računa o isporuci, distribuciji i sakupljanju izveštaja o vitalnim statistikama i delimično ABD na terenu, kontaktira sa ispitanicima i daje uputstva o popunjavanju obrazaca za statističke ankete;

- Vrši logičku analizu statističkih istraživanja;

- Vodi računa o isporuci, distribuciji i sakupljanju izveštaja na terenu;

- Na zahtev šefa regionalne kancelarije prati i nadgleda lica koja su angažovana na terenu tokom procesa realizacije projekta, i razvija dobre odnose sa ispitanicima;

-Izveštava šefu regionalne kancelarije o dinamici aktivnosti prema dnevnom redu koji je dostavljen od Odeljenja ASK-a.

Kvalifikacija: Univerzitetska diploma- Ekonomski fakultet, fakultet iz oblasti društvenih nauka ili pravni fakultet.

Radno iskustvo: poželjno u relevantnoj oblasti.

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje rada na računaru (word, excel, Outlook);
- Saradnja u timski rad, potrebni;
- Sposobnost da sačuva poverljivost pojedinačnih statističkih podataka;

- Veštine u izvršavanju radova i zadataka prema godišnjem planu regionalne kancelarije – su potrebne;
- Entuzijasta, energičan, diplomata, diskretan-potrebno;
- Ažuran i spreman za obavljanje radnih zadataka-potrebno.

Zadaci i odgovornosti: Službenik za Statistiku u Regionalnoj Kancelariji u Đakovici

- Obavlja ankete za sva istraživanja na nivou regiona Đakovice;

- Vodi računa o isporuci i distribuciji materijala na terenu; prikupljanju materijala iz izveštajnih jedinica, kontroli i sistematizaciji izveštaja o vitalnim statistikama;

- Popunjavanje, prati i kontroliše kvartalnih izveštaja o kratkoročnim statistikama industrije;

- Popunjavanje, prati i kontroliše kvartalnih izveštaja o kratkoročnim statistikama izgradnje;

- Popunjavanje, prati i kontroliše Cene ICGP (IQPV);

- Popunjavanje, prati i kontroliše Uvozne Cene;

- Distribuirati, popunjavanje i kontroliše Anketu o Budžetu Domaćinstva;

- Popunjavanje i prati Izveštaje o Kulturi i Sportu;

- Razvija dobre odnose sa ispitanicima i daje uputstva o popunjavanju obrazaca za statističke ankete;

-Vrši kontrolu i logičku analizu kao i vodi računa o raspodelu, distribuciju i prikupljanju izveštaja sa terena;

- Na zahtev šefa regionalne kancelarije prati i nadgleda lica koja su angažovana na terenu tokom procesa realizacije projekta koje je planirala ASK;

-Izveštava šefu regionalne kancelarije o dinamici aktivnosti prema dnevnom redu koji je dostavljen od Odeljenja ASK-a.

Kvalifikacija: Univerzitetska diploma- Ekonomski fakultet, fakultet iz oblasti društvenih nauka ili pravni fakultet.

Radno iskustvo: poželjno u relevantnoj oblasti.

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje rada na računaru (word, excel, Outlook);

- Saradnja u timski rad, potrebni;

- Sposobnost da sačuva poverljivost pojedinačnih statističkih podataka;

- Veštine u izvršavanju radova i zadataka prema godišnjem planu regionalne kancelarije – su potrebne;

- Entuzijasta, energičan, diplomata, diskretan-potrebno;

- Ažuran i spreman za obavljanje radnih zadataka-potrebno.

Zadaci i odgovornosti: Službenik za Statistiku u Regionalnoj Kancelariji u Peći

- Obavlja ankete za sva statistička istraživanja na nivou regiona Peći;

- Mesečne izveštaje demografije;

- Izveštaje o indeksu cena troškova izgradnje, industrije, uvoza-izvoza;

- Mesečne izveštaje cena u poljoprivredi, ankete IKT-a;

- Vrši logičku analizu i analizu statističkih istraživanja, kao i brine o raspodeli, distribuciji i prikupljanju izveštaja sa terena;

- Izveštaje o godišnjim statistikama o vodama i ribarstvu, komunalnom otpadu.

- Na zahtev šefa regionalne kancelarije prati i nadgleda lica koja su angažovana na terenu tokom procesa realizacije projekta koje je planirala ASK;

--Izveštava šefu regionalne kancelarije o dinamici aktivnosti prema dnevnom redu koji je dostavljen od Odeljenja ASK-a.

Kvalifikacija: Univerzitetska diploma- Ekonomski fakultet, fakultet iz oblasti društvenih nauka ili pravni fakultet.

Radno iskustvo: poželjno u relevantnoj oblasti.

Kompetencije i veštine:

- Poznavanje rada na računaru (word, excel, Outlook);

- Saradnja u timski rad, potrebni;

- Sposobnost da sačuva poverljivost pojedinačnih statističkih podataka;

- Veštine u izvršavanju radova i zadataka prema godišnjem planu regionalne kancelarije – su potrebne;

- Entuzijasta, energičan, diplomata, diskretan-potrebno;

- Ažuran i spreman za obavljanje radnih zadataka-potrebno.

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svih punoletni (18 i više godina) građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na internet stranici ASK-a.

Podnošenje prijave:

Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a:

<http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul. "Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz prijavu potrebno je priložiti: CV¹, kopiju lične karte, Diplomom fakulteta, kao i ostalu potrebnu dokumentaciju koja je potrebna prema konkursu (svi dokumenti treba da budu kopije).

Nepotpune prijave i one podnete nakon isteka roka neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Aplikacije poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci od poslednjeg dana roka za podnošenje prijave, smatraće se važećim i ujedno smatrat će se važeća ako stignu u roku od 3 dana, prijave/aplikacije koje stižu posle navedenog roka, i ujedno nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31 149 ili 038-200 31 141 od 08:00 – 16: 00 časova.

¹ Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu

Sot me datën: 10.02.2020 u bënë 2 vite pa ty Babi



Shaban (Ruzhdi) Sermaxhaj

(05.01.1969-10.02.2018)

Të rënda qenkan ditët kur mungon prania jote. Ishe dhe do të mbetesh gjithmonë krenaria e familjes sonë. Është e vështirë të shkruajmë për ty Babi, por megjithatë jemi krenarë që të patëm një Bashkëshort dhe Babë siç ishe ti. Kjo na bënë të mos të harrojmë përjetë e mot. Dashuria, mirësia dhe urtësia që kishe ndaj nesh, na bëjnë që mos të harrojmë kurrë.

Të jetosh në zemrat e atyre që le pas, do të thotë të mos vdesësh kurrë.

Gjithmonë krenarë që të patëm dhe shumë të pikëlluar që të humbëm: Bashkëshortja Xhevahirja, djali Ilazim, vajzat Donjeta dhe Loreta

Sot u bënë 2 vite pa ty Vëlla dhe 4 Muaj pa ty Motër



**Shaban (Ruzhdi)
Sermaxhaj**

(5.01.1969-10.02.2018)



**Fatime (Sermaxhaj)
Xheladini**

(1958-2019)

Edhe ky muaj e ky vit shtoi të ftohtin në ne. Arrijmë ti ngrohim zemrat tona me kujtimet për ju, duke ju kujtuar dashurinë e madhe që na latë në mendje dhe zemrat tona. Koha po ecën e malli për ju rritet çdo ditë. Mungesa juaj është zbrastësi që nuk plotësohet kurrë.

Puna, veprat dhe fjalët e juaja do të na mbetin gjithmonë udhërrëfim për ne.

Me mall të pashuar gjithmonë në zemrat tona ju kujtojmë: Nëna; Hata, Motrat; Fatmirja, Habibja, Lumnija, Luljeta e Qamilja dhe Vëllezërit; Enveri, Nuhija, Jahiu.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

